

GJYKATA E APELIT

Prishtinë

Numri i lëndës: PAKR 220/16
(PKR 1098/13 Gjykata Themelore e Prishtinës)

Data: 26 prill 2017

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vahid Haliti (kryetar i trupit gjykues), gjyqtari i EULEX-it Radostin Petrov (gjyqtar raportues), gjyqtari i Gjykatës së Apelit Fillim Skoro si anëtarë të trupit gjykues, dhe zyrtarja ligjore e EULEX-it Sandra Gudaityte si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të pandehurve, në mesin e të tjerëve

G.K.;

S.S.;

N.D.;

S.A.;

N.Z.;

J.R.;

N.S.;

Xh.H.;

V.K.;

Z.S.;

I.R.;

Të akuzuar sipas aktakuzës PP: II 111/2013 të datës 11 dhjetor 2013 dhe e plotësuar me 8 korrik 2014 për veprat penale si në vijim:

G.K., S.S., N.D., S.A., N.Z., J.R., N.S., Xh.H., V.K., Z.S. dhe I.R. **me** PIKËN 1: Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198 (1) të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm "KPK"); PIKA 2: Sulmi, në kundërshtim me nenin 187 (1) të KPK-së lidhur me nenin 31 të KPK-së; PIKA 3: Sulmi, në kundërshtim me nenin 187 (2) të KPK-së lidhur me nenin 31 të KPK-së; PIKA 4: Sulmi, në kundërshtim me nenin 187 (3) të KPK-së lidhur me nenin 31 të KPK-së;

G.K., N.D. dhe S.A. **me** PIKËN 5: Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198 (1) të KPK-së, i lidhur me nenin 31 të KPK-së;

S.A. **me** PIKËN 6: Kanosja, në kundërshtim me nenin 185 (4) lidhur me paragrafin 1 të KPK-së;

G.K. **me** PIKËN 7: Kanosja, në kundërshtim me nenin 185 (4), lidhur me paragrafin 1 të KPK-së; PIKA 8: Sulmi, në kundërshtim me nenin 187 (1) të KPK-së; PIKA 9: Sulmi, në kundërshtim me nenin 187 (2) lidhur me paragrafin 1 të KPK-së; PIKA 10: Sulmi, në kundërshtim me nenin 187(3), lidhur me paragrafin 1 të KPK-së;

S.S., N.Z., N.S. dhe Xh.H. **me** PIKËN 11: Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198 (1), të KPK-së, lidhur me nenin 31 të KPK-së;

V.K., Z.S., J.R. dhe I.R. **me** PIKËN 12: Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198 (1) të KPK-së, lidhur me nenin 31 të KPK-së;

G.K. me PIKËN 13: Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198 (1) të KPK-së, PIKA 14: Sulmi, në kundërshtim me nenin 187(3) lidhur me paragrafin 1 të KPK-së;

S.S. me PIKËN 15: Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198 (1) të KPK-së, PIKA 16: Sulmi, në kundërshtim me nenin 187 (3) lidhur me paragrafin 1 të KPK-së;

G.K. dhe N.D. me PIKËN 17: Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198 (1) të KPK-së lidhur me nenin 31 të KPK-së; PIKA 18: Sulmi, në kundërshtim me nenin 187 (2) lidhur me paragrafin 1 të KPK-së, lidhur me nenin 31 të KPK-së; PIKA 19: Sulmi, në kundërshtim me nenin 187 (3), lidhur me paragrafin 1 të KPK-së, lidhur me nenin 31 të KPK-së;

Duke vepruar sipas ankesave kundër Aktgjykimit PKR 1098/13 të Gjykatës Themelore të Prishtinës të datës 18 nëntor 2015 të paraqitur nga avokati mbrojtës A.R. në emër të të pandehurit G.K. më 12 mars 2016, avokatit mbrojtës N.S. në emër të të pandehurit S.S. më 10 mars 2016, avokatit mbrojtës R.D. në emër të të pandehurit S.A. më 10 mars 2016, avokatit mbrojtës K.P. në emër të të pandehurit N.D. më 16 mars 2016, avokatit mbrojtës G.A. në emër të të pandehurit N.Z. më 16 mars 2016, avokates mbrojtëse A.K. në emër të të pandehurit I.R. më 14 mars 2016, të pandehurit I.R. më 9 mars 2016, dhe Prokurorisë Themelore të EULEX-it (në tekstin e mëtejme "Prokurori") më 11 mars 2016;

Pas shqyrtimit të përgjigjeve në ankesë të Prokurorisë Themelore të EULEX-it, të paraqitura nga avokati mbrojtës R.D. në emër të të pandehurit S.A. më 21 mars 2016, avokates mbrojtëse F.B. në emër të të pandehurit N.S. më 22 mars 2016, avokates mbrojtëse M.S.E. në emër të të pandehurit Z.S. më 23 mars 2016, avokatit mbrojtës N.S. në emër të të pandehurit J.R. më 31 mars 2016 dhe përgjigjes në ankesa të paraqitura nga avokati mbrojtës dhe të pandehurit nga Prokurori më 6 prill 2016;

Pas shqyrtimit të mocionit të Prokurorisë së Apelit (në tekstin e mëtejme "Prokurori i Apelit") të parashtruar më 9 qershor 2016;

Pas mbajtjes së seancës publike më 25 prill 2017;

Pas shqyrtimit dhe votimit më 26 prill 2017;

Në pajtim me nenet 389, 390, 394, 398 dhe 401 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejme: 'KPP')

lëshon si në vijim

AKTGJYKIM

- I. Refuzohet si e bazuar ankesa kundër Aktgjykimit PKR 1098/13 të Gjykatës Themelore të Prishtinës të datës 18 nëntor 2015 e parashtruar nga Prokuroria Themelore e EULEX-it më 11 mars 2016.**

- II. Ankesat kundër Aktgjykimit PKR 1098/13 të Gjykatës Themelore të Prishtinës të datës 18 nëntor 2015, të paraqitura nga avokati mbrojtës A.R. në emër të të pandehurit G.K. më 12 mars 2016, avokatit mbrojtës NS në emër të të pandehurit S.S. më 10 mars 2016, avokatit mbrojtës R.D. në emër të të pandehurit S.A. më 10 mars 2016, avokatit mbrojtës K.P. në emër të të pandehurit N.D. më 16 mars 2016, avokatit mbrojtës G.A. në emër të të pandehurit N.Z. më 16 mars 2016, avokates mbrojtëse A.K. në emër të të pandehurit I.R. më 14 mars 2016, të pandehurit I.R. më 9 mars 2016 pjesërisht aprovohen.**

III. Aktgjykimi PKR 1098/13 i Gjykatës Themelore të Prishtinës i datës 18 nëntor 2015 ndryshohet si vijon:

a. I pandehuri G.K.

I pandehuri G.K. lirohet nga veprat penale të Sulmit, në kundërshtim me nenin 187 (1) të KPK-së (*Pika 2*) dhe Sulmit, në kundërshtim me nenin 187 (1) të KPK-së (*Pika 8*) siç përshkruhet në aktgjykimin e shkallës së parë, për shkak se vepra penale e Sulmit siç përshkruhet në nenin 187 (1) të KPK-së, përfshihet nga vepra penale më specifike Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, siç përshkruhet në nenin 198 (1) të KPK-së.

I pandehuri G.K. lirohet nga veprat penale të Sulmit, në kundërshtim me nenin 187 (2) të KPK në lidhje me nenin 31 të KPK-së (*Pika 3*), Sulmit, në kundërshtim me nenin 187 (2) të KPK-së në lidhje me nenin 31 të KPK-së (*Pika 18*) dhe Sulmit, në kundërshtim me nenin 187 (2) të KPK-së (*Pika 9*), siç përshkruhet në aktgjykimin e shkallës së parë, për shkak se elementet e veprës penale të Sulmit siç përshkruhen në nenin 187 (2) të KPK-së nuk janë plotësuar deri më tani pasi që nuk është vërtetuar se sulmi është kryer me armë, instrument të rrezikshëm ose ndonjë objekt tjetër që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor ose dëmtim serioz për shëndetin.

Aktgjykimi PKR 1098/13 i Gjykatës Themelore të Prishtinës i datës 18 nëntor 2015 mbetet i pandryshuar në pjesët që është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri G.K. ka kryer veprat penale të Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198 (1) të KPK-së të kryera kundër palës së dëmtuar M.J. (*Pika 1*), Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, I.P. (*Pika 1*), Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimit publik, në kundërshtim me nenin 198 (1) të KPK-së në lidhje me nenin 31 të KPK-së të kryer në vazhdim ndaj palës së dëmtuar B.M. (*Pikat 5 dhe 13*), Kanosje në kundërshtim me nenin 185 (4), lidhur me paragrafin 1 të KPK-së, dhe në lidhje me nenin 31 të KPK-së të kryer

kundër palës së dëmtuar B.M. (Pika 7) dhe Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike në kundërshtim me nenin 198 (1) të KPK-së në lidhje me nenin 31 të KPK-së të kryera kundër palës së dëmtuar D.V. (Pika 17).

Aktgjykimi PKR 1098/13 i Gjykatës Themelore të Prishtinës i datës 18 nëntor 2015 mbetet i pandryshuar në pjesët që sipas nenit 364 (1) (1.3) të KPK-së, i pandehuri G.K. ishte liruar nga veprat penale të Sulmit, në kundërshtim me nenin 187 (3) në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së në lidhje me nenin 31 të KPK-së (Pika 4), Sulmit në bazë të nenit 187 (3) në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së (Pika 10), Sulmit, në kundërshtim me nenin 187 (3) në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së (Pika 14) dhe Sulmit, në kundërshtim me nenin 187 (3) në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së në lidhje me nenin 31 të KPK-së (Pika 19).

Fjalja ndryshohet si më poshtë:

Për veprën penale të Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198 (1) të KPK-së të kryer kundër palës së dëmtuar M.J. (Pika 1), në pajtim me nenet 41, 45, 74 dhe 198 (1) të KPK-së, i pandehuri dënohet me burgim prej 8 (tetë) muajsh ndërsa ekzekutimi pezullohet sipas nenit 51 (2) të KPK-së për periudhën e verifikimit prej 2 (dy) vjetësh nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit.

Për veprën penale të Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198 (1) të KPK-së të kryera kundër palës së dëmtuar I.P. (Pika 1), sipas neneve 41, 45, 74 dhe 198 (1) të KPK-së, i pandehuri dënohet me burgim prej 8 (tetë) muajsh ndërsa ekzekutimi pezullohet sipas nenit 51 (2) të KPK-së për periudhën e verifikimit prej 2 (dy) vjetësh nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit.

Për veprën penale të Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198 (1) të KPK-së në lidhje me nenin 31 të KPK-së, të kryer në vazhdim ndaj palës së dëmtuar B.M. (Pikat 5 dhe 13), sipas nenit 41, 45, 74 dhe

198 (1) të KPK-së, i pandehuri dënohet me burgim prej 8 (tetë) muajve ndërsa ekzekutimi pezullohet sipas nenit 51 (2) të KPK-së për periudhën e verifikimit prej 2 vjetësh nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit.

Për veprën penale të Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publik, në kundërshtim me nenin 198 (1) të KPK në lidhje me nenin 31 të KPK-së të kryera kundër palës së dëmtuar D.V. (*Pika 17*), në pajtim me nenet 41, 45 , 74 dhe 198 (1) të KPK-së, i pandehuri dënohet me burgim prej 8 (tetë) muajsh ndërsa ekzekutimi pezullohet sipas nenit 51 (2) të KPK-së për periudhën e verifikimit prej 2 (dy) vjetësh nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit.

Për veprën penale të Kanosjes, në kundërshtim me nenin 185 (4), në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së, dhe në lidhje me nenin 31 të KPK-së të kryera kundër palës së dëmtuar B.M. (*Pika 7*), në pajtim me nenet 41, 45 , 74 dhe 185 (4) të KPK-së, i pandehuri dënohet me burgim prej një (një) viti ndërsa ekzekutimi pezullohet sipas nenit 51 (2) të KPK-së për periudhën e verifikimit prej 2 (dy) vjetësh nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit.

Në bazë të nenit 80 të KPK-së, Gjykata e Apelit shqipton dënimin unik prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj burgim ndërsa ekzekutimi pezullohet sipas nenit 51 (2) të KPK-së për periudhën e verifikimit prej 3 (tri) viteve nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit.

b. I pandehuri S.S.

I pandehuri S.S. lirohet nga veprat penale të Sulmit, në kundërshtim me nenin 187 (1) të KPK-së (*Pika 2*) siç përshkruhet në aktgjykimin e shkallës së parë, sepse vepra penale e Sulmit siç përshkruhet në nenin 187 (1) të KPK-së, përfshihet nga vepra penale më specifike Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, siç përshkruhet në nenin 198 (1) të KPK-së.

I pandehuri S.S. lirohet nga veprat penale të Sulmit, në kundërshtim me nenin 187 (2) të KPK-së (*Pika 3*), siç përshkruhet në aktgjykimin e shkallës së parë, për shkak se elementet e veprës penale të Sulmit siç përshkruhen në nenin 187 (2) të KPK-së nuk janë plotësuar deri më tani pasi që nuk është vërtetuar se sulmi është kryer me armë, instrument të rrezikshëm ose ndonjë objekt tjetër që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor ose dëmtim serioz për shëndetin.

Aktgjykimi PKR 1098/13 i Gjykatës Themelore të Prishtinës i datës 18 nëntor 2015 mbetet i pandryshuar në pjesët që është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri S.S. ka kryer veprat penale të Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198 (1) të KPK-së të kryer në vazhdim ndaj palës së dëmtuar B.M.1 (*Pikat 1 dhe 15*), të KPK-së dhe Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike në kundërshtim me nenin 198 (1) të KPK-së të kryera kundër palës së dëmtuar I.P. (*Pika 1*).

Aktgjykimi PKR 1098/13 i Gjykatës Themelore të Prishtinës i datës 18 nëntor 2015 mbetet i pandryshuar në pjesët që sipas nenit 364 (1) (1.3) të KPK-së, i pandehuri S.S. ishte liruar nga veprat penale të Sulmit, në kundërshtim me nenin 187 (3) në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së në lidhje me nenin 31 të KPK-së (*Pika 4*), Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike në kundërshtim me nenin 198 (1) të KPK-së në lidhje me nenin 31 të KPK-së (*Pika 11*) dhe Sulmit, në kundërshtim me nenin 187 (3) në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së në lidhje me nenin 31 të KPK-së (*Pika 16*).

Fjalja ndryshohet si më poshtë:

Për veprën penale të Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198 (1) të KPK-së të kryer në vazhdim kundër palës së dëmtuar B.M.1 (*Pikat 1 dhe 15*), në pajtim me nenet 41, 45, 74 dhe 198 (1) të KPK-së, i pandehuri dënohet me 1 (një) vit burgim ndërsa ekzekutimi pezullohet sipas nenit 51 (2) të KPK-së për periudhën e verifikimit prej 2 (dy) vjetësh nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë veper tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit.

Për veprën penale të Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198 (1) të KPK-së të kryera kundër palës së dëmtuar I.P. (Pika 1), sipas neneve 41, 45, 74 dhe 198 (1) të KPK-së, i pandehuri dënohet me 1 (një) vit burgim ndërsa ekzekutimi pezullohet sipas nenit 51 (2) të KPK-së për periudhën e verifikimit prej 2 (dy) vjetësh nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit.

Në bazë të nenit 80 të KPK-së, Gjykata e Apelit shqipton dënimin unik prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj burgim ndërsa ekzekutimi pezullohet sipas nenit 51 (2) të KPK-së për periudhën e verifikimit prej 3 (tri) viteve nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit.

c. I pandehuri S.A.

Aktgjykimi PKR 1098/13 i Gjykatës Themelore të Prishtinës i datës 18 nëntor 2015 mbetet i pandryshuar në pjesët që është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri S.A. ka kryer veprat penale të Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198 (1) të KPK-së në lidhje me nenin 31 të KPK-së kundër palës së dëmtuar B.M. (Pika 5) dhe të Kanosjes në kundërshtim me nenin 185 (4), lidhur me paragrafin 1 të KPK-së, dhe në lidhje me nenin 31 të KPK-së të kryer kundër të dëmtuarit B.M. (Pika 6).

Aktgjykimi PKR 1098/13 i Gjykatës Themelore të Prishtinës i datës 18 nëntor 2015 mbetet i pandryshuar në pjesët që sipas nenit 364 (1) (1.3) të KPK-së, i pandehuri S.A. ishte liruar nga veprat penale të Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198 (1) të KPK-së në lidhje me nenin 31 të KPK-së (Pika 1) Sulmit, në kundërshtim me nenin 187 (1) të KPK-së në lidhje me nenin 31 të KPK-së (Pika 2), Sulmit në kundërshtim të nenit 187 (2) të KPK-së në lidhje me nenin 31 të KPK-së (Pika 3), dhe Sulmit, në kundërshtim me nenin 187 (3) në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së në lidhje me nenin 31 të KPK-së (Pika 4).

Fjalja ndryshohet si më poshtë:

Për veprën penale të Keqtrajtit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198 (1) të KPK-së në lidhje me nenin 31 të KPK-së kundër palës së dëmtuar B.M. (Pika 5), në pajtim me nenet 41, 45, 74 dhe 198 (1) të KPK-së, i pandehuri dënohet me 1 (një) vit burgim ndërsa ekzekutimi pezullohet sipas nenit 51 (2) të KPK-së për periudhën e verifikimit prej 2 (dy) vjetësh nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit.

Për veprën penale të Kanosjes, në kundërshtim me nenin 185 (4), në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së, dhe në lidhje me nenin 31 të KPK-së të kryera kundër palës së dëmtuar B.M. (Pika 6), në pajtim me nenet 41, 45 , 74 dhe 185 (4) të KPK-së, i pandehuri dënohet me 1 (një) vit burgim ndërsa ekzekutimi pezullohet sipas nenit 51 (2) të KPK-së për periudhën e verifikimit prej 2 (dy) vjetësh nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit.

Në bazë të nenit 80 të KPK-së, Gjykata e Apelit shqipton dënimin unik prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj burgim ndërsa ekzekutimi pezullohet sipas nenit 51 (2) të KPK-së për periudhën e verifikimit prej 2 (dy) viteve nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit.

d. I pandehuri N.D.

I pandehuri N.D. lirohet nga veprat penale të Sulmit, në kundërshtim me nenin 187 (1) të KPK-së siç përshkruhet në aktgjykimin e shkallës së parë, sepse vepra penale e Sulmit siç përshkruhet në nenin 187 (1) të KPK-së, përfshihet nga vepra penale më specifike Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, siç përshkruhet në nenin 198 (1) të KPK-së.

I pandehuri N.D. lirohet nga veprat penale të Sulmit, në kundërshtim me nenin 187 (2) të KPK në lidhje me nenin 31 të KPK-së (*Pika 18*) siç përshkruhet në aktgjykimin e shkallës së parë, sepse elementet e veprës penale të Sulmit siç përshkruhen në nenin 187 (2) të KPK-së nuk janë plotësuar deri më tani pasi që nuk është vërtetuar se sulmi është kryer me armë, instrument të rrezikshëm ose ndonjë objekt tjetër që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor ose dëmtim serioz për shëndetin.

Aktgjykimi PKR 1098/13 i Gjykatës Themelore të Prishtinës i datës 18 nëntor 2015 mbetet i pandryshuar në pjesët që është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri N.D. ka kryer veprat penale të Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198 (1) të KPK-së në lidhje me nenin 31 të KPK-së të kryer në vazhdim ndaj palës së dëmtuar B.M. (*Pika 5*), dhe Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike në kundërshtim me nenin 198 (1) të KPK-së në lidhje me nenin 31 të KPK-së të kryera kundër palës së dëmtuar D.V. (*Pika 17*).

Aktgjykimi PKR 1098/13 i Gjykatës Themelore të Prishtinës i datës 18 nëntor 2015 mbetet i pandryshuar në pjesët që sipas nenit 364 (1) (1.3) të KPK-së, i pandehuri N.D. ishte liruar nga veprat penale të Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike në kundërshtim me nenin 198 (1) të KPK-së në lidhje me nenin 31 të KPK-së (*Pika 1*), Sulmit, në kundërshtim me nenin 187 (1) të KPK-së në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së në lidhje me nenin 31 të KPK-së (*Pika 2*), Sulmit në bazë të nenit 187 (2) në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së (*Pika 3*), Sulmit, në kundërshtim me nenin 187 (3) në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së në lidhje me nenin 31 të KPK-së (*Pika 4*) dhe Sulmit, në kundërshtim me nenin 187 (3) në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së në lidhje me nenin 31 të KPK-së (*Pika 19*).

Fjalja ndryshohet si më poshtë:

Për veprën penale të Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198 (1) të KPK-së në lidhje me nenin 31 të KPK-së të kryer kundër palës së dëmtuar B.M. (*Pika 5*), në pajtim me nenet 41, 45, 74 dhe 198 (1) të

KPK-së, i pandehuri dënohet me 1 (një) vit burgim ndërsa ekzekutimi pezullohet sipas nenit 51 (2) të KPK-së për periudhën e verifikimit prej 2 (dy) vjetësh nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit.

Për veprën penale të Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198 (1) të KPK-së në lidhje me nenin 31 të KPK-së të kryera kundër palës së dëmtuar D.V. (Pika 17), sipas neneve 41, 45, 74 dhe 198 (1) të KPK-së, i pandehuri dënohet me 1 (një) vit burgim ndërsa ekzekutimi pezullohet sipas nenit 51 (2) të KPK-së për periudhën e verifikimit prej 2 (dy) vjetësh nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit.

Në bazë të nenit 80 të KPK-së, Gjykata e Apelit shqipton dënimin unik prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj burgim, ndërsa ekzekutimi pezullohet sipas nenit 51 (2) të KPK-së për periudhën e verifikimit prej 2 (dy) viteve nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit.

e. I pandehuri N.Z.

I pandehuri N.Z. lirohet nga veprat penale të Sulmit, në kundërshtim me nenin 187 (1) të KPK-së (Pika 2) siç përshkruhet në aktgjykimin e shkallës së parë, sepse vepra penale e Sulmit siç përshkruhet në nenin 187 (1) të KPK-së, përfshihet nga vepra penale më specifike Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, siç përshkruhet në nenin 198 (1) të KPK-së.

Aktgjykimi PKR 1098/13 i Gjykatës Themelore të Prishtinës i datës 18 nëntor 2015 mbetet i pandryshuar në pjesët që është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri N.Z. ka kryer veprat penale të Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198 (1) të KPK-së të kryera kundër palës së dëmtuar I.P. (Pikat 1 dhe 11).

Aktgjykimi PKR 1098/13 i Gjykatës Themelore të Prishtinës i datës 18 nëntor 2015 mbetet i pandryshuar në pjesët që sipas nenit 364 (1) (1.3) të KPK-së, i pandehuri N.Z. ishte liruar nga veprat penale të Sulmit, në kundërshtim me nenin 187 (3) në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së në lidhje me nenin 31 të KPK-së (*Pika 3*) dhe Sulmit, në kundërshtim me nenin 187 (3) në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së në lidhje me nenin 31 të KPK-së (*Pika 4*).

Fjalja ndryshohet si më poshtë:

Për veprën penale të Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198 (1) të KPK-së të kryer kundër palës së dëmtuar I.P. (*Pikat 1 dhe 11*), në pajtim me nenet 41, 45, 74 dhe 198 (1) të KPK-së, i pandehuri dënohet me burgim prej 6 (tetë) muajsh, ndërsa ekzekutimi pezullohet sipas nenit 51 (2) të KPK-së për periudhën e verifikimit prej 2 (dy) vjetësh nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit.

f. I pandehuri I.R.

I pandehuri I.R. lirohet nga veprat penale të Sulmit, në kundërshtim me nenin 187 (1) të KPK-së (*Pika 2*) siç përshkruhet në aktgjykimin e shkallës së parë, sepse vepra penale e Sulmit siç përshkruhet në nenin 187 (1) të KPK-së, përfshihet nga vepra penale më specifike Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, siç përshkruhet në nenin 198 (1) të KPK-së.

Aktgjykimi PKR 1098/13 i Gjykatës Themelore të Prishtinës i datës 18 nëntor 2015 mbetet i pandryshuar në pjesën ku është vërtetuar tej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri I.R. e ka kryer veprën penale të keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshti me nenin 198(1) të KPK-së, kundër të dëmtuarit B.M.1 (*pika 1 e aktakuzës*).

Aktgjykimi PKR 1098/13 i Gjykatës Themelore të Prishtinës i datës 18 nëntor 2015 mbetet i pandryshuar në pjesët në të cilat, sipas nenit 364(1)(1.3) të KPK-së, i pandehuri I.R. është

liruar nga akuzat për veprat penale të sulmit, në kundërshti me nenin 187(2) të KPK-së, në lidhje me nenin 31 të KPK-së (*pika 3 e aktakuzës*), sulmit, në kundërshti me nenin 187(3), në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së, në lidhje me nenin 31 të KPK-së (*pika 4 e aktakuzës*), dhe keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshti me nenin 198(1) të KPK-së, në lidhje me nenin 31 të KPK-së (*pika 12 e aktakuzës*).

Dënimi ndryshohet si vijon:

Për veprën penale të keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshti me nenin 198(1) të KPK-së, kundër palës së dëmtuar B.M.1 (*pika 1 e aktakuzës*), sipas neneve 41, 45, 74 dhe 198(1) të KPK-së, i pandehuri dënohet me burgim prej 6 (gjashtë) muajve, ndërsa ekzekutimi pezullohet sipas nenit 51(2) të KPK-së për periudhën e verifikimit prej 1 (një) viti, nëse i pandehuri nuk kryen vepër penale tjetër gjatë periudhës së verifikimit.

IV. Pjesët e tjera të ankesave që janë radhitur në pjesën II të dispozitivit refuzohen si të pabazuara.

ARSYETIM

I. Historiku i procedurës

1. Më 12 dhjetor të vitit 2013, Prokuroria Themelore e EULEX-it e ka ngritur Aktakuzën PP: II 111/2013 kundër G.K. dhe të pandehurve të tjerë, duke i ngarkuar ata me 19 pika të aktakuzës për veprat penale të keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshti me nenin 198 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së); sulmit, në kundërshti me nenin 187 të KPK-së; dhe kërcënimit, në kundërshti me nenin 185 të KPK-së.
2. Shqyrtimi gjyqësor ka filluar më 8 korrik të vitit 2014, ndërsa është përfunduar më 11 nëntor të vitit 2015. Gjatë tij janë mbajtur 43 seanca gjyqësore. Më 18 nëntor të vitit 2015, Gjykata Themelore e ka marrë Aktgjykimin PKR 1098/13.
3. **G.K.** është shpallur fajtor për veprat penale në vijim: keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshti me nenin 198(1) të KPK-së, e kryer pjesërisht, në bashkëkryerje, sipas nenit 31 të KPK-së; sulmi, në kundërshti me nenin 187(1) të KPK-së; sulmi, në kundërshti me nenin 187(2) të KPK-së, të kryer në bashkëkryerje, sipas nenit 31 të KPK-së; dhe kërcënim, në kundërshti me nenin 185(4) të KPK-së, të kryer në bashkëkryerje, sipas nenit 31 të KPK-së. Atij i është shqiptuar dënimi në bashkim me burgim prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muajve, ndërsa i është ndaluar që të ushtrojë funksione të administratën publike ose në shërbimin publik për 2 (dy) vite. G.K. është liruar nga akuzat në vijim: Sulmi, në kundërshti me nenin 187(3), në lidhje me paragrafin 1, në lidhje me nenin 31 të KPK-së (pika 4 e aktakuzës); sulmi, në kundërshti me nenin 187(3), në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së (pika 10 e aktakuzës); sulmi, në kundërshti me nenin 187(3), në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së (pika 14 e aktakuzës); sulmi, në kundërshti me nenin 187(3) në lidhje me paragrafin 1, në lidhje me nenin 31 të KPK-së (pika 19 e aktakuzës).
4. **S.S.** është shpallur fajtor për veprat penale në vijim: keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshti me nenin 198(1) të KPK-së; sulmi, në

kundërshti me nenin 187(2) të KPK-së; dhe sulmi, në kundërshti me nenin 187(1) të KPK-së. Atij i është shqiptuar dënimi në bashkim prej 2 (dy) viteve burgim me pezullimin e ekzekutimit të dënimit sipas nenit 51(2) të KPK-së për periudhën e verifikimit prej 3 (tri) viteve, ndërsa i është ndaluar që të ushtrojë funksione të administratën publike ose në shërbimin publik për 3 (tri) vite. S.S. është liruar nga akuzat në vijim: Sulmi, në kundërshti me nenin 187(3) në lidhje me paragrafin 1, në lidhje me nenin 31 të KPK-së (pika 4 e aktakuzës); keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshti me nenin 198(1) të KPK-së, në lidhje me nenin 31 të KPK-së (pika 11 e aktakuzës); dhe sulmi, në kundërshti me nenin 187(3) në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së (pika 16 e aktakuzës).

5. **S.A.** është shpallur fajtor për veprat penale në vijim: keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshti me nenin 198(1) të KPK-së në lidhje me nenin 31 të KPK-së; dhe kërcënimi, në kundërshti me nenin 185(4) të KPK-së, të kryer në bashkëkryerje sipas nenit 31 të KPK-së. Atij i është shqiptuar dënimi në bashkim me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim me pezullim të ekzekutimit të dënimit sipas nenit 51(2) të KPK-së për periudhën e verifikimit prej 2 (dy) viteve, ndërsa është urdhëruar që të mos mbajë kurrfarë arme gjatë kohës së verifikimit. Të pandehurit pastaj i është shqiptuar dënimi me ndalim të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik për 2 (dy) vite. S.A. është liruar nga akuzat në vijim: keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshti me nenin 198(1) të KPK-së, në lidhje me nenin 31 të KPK-së (pika 1 e aktakuzës); sulmi, në kundërshti me nenin 187(1) në lidhje me paragrafin 1, në lidhje me nenin 31 të KPK-së (pika 2 e aktakuzës); sulmi, në kundërshti me nenin 187(2), në lidhje me paragrafin 1, në lidhje me nenin 31 të KPK-së (pika 3 e aktakuzës); sulmi, në kundërshti me nenin 187(3) në lidhje me paragrafin 1, në lidhje me nenin 31 të KPK-së (pika 4 e aktakuzës).
6. **N.D.** është shpallur fajtor për veprat penale në vijim: keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshti me nenin 198(1) të KPK-së, në lidhje me nenin 31 të KPK-së; sulmi, në kundërshti me nenin 187(1) të KPK-së, dhe sulmi, në kundërshti me nenin 187(2) të KPK-së, i kryer në bashkëkryerje, sipas nenit 31 të KPK-së.

Atij i është shqiptuar dënimi në bashkim me 2 (dy) vite burgim me pezullim të ekzekutimit të dënimit sipas nenit 51(2) të KPK-së për periudhën e verifikimit prej 2 (dy) viteve. Të pandehurit pastaj i është shqiptuar dënimi me ndalim të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik për 3 (tri) vite. N.D. është liruar nga akuzat në vijim: keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshti me nenin 198(1) të KPK-së, në lidhje me nenin 31 të KPK-së (pika 1 e aktakuzës); sulmi, në kundërshti me nenin 187(1), në lidhje me paragrafin 1, në lidhje me nenin 31 të KPK-së (pika 2 e aktakuzës); sulmi, në kundërshti me nenin 187(2) në lidhje me paragrafin 1, në lidhje me nenin 31 të KPK-së (pika 3 e aktakuzës); sulmi, në kundërshti me nenin 187(3) në lidhje me paragrafin 1, në lidhje me nenin 31 të KPK-së (pika 4 e aktakuzës); sulmi, në kundërshti me nenin 187(3) në lidhje me paragrafin 1, në lidhje me nenin 31 të KPK-së (pika 19 e aktakuzës).

7. **N.Z.** është shpallur fajtor për veprat penale në vijim: keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshti me nenin 198(1) të KPK-së; dhe sulmi, në kundërshti me nenin 187(1) të KPK-së. Atij i është shqiptuar dënimi në bashkim me 1 (një) vit burgim me pezullim të ekzekutimit të dënimit sipas nenit 51(2) të KPK-së për periudhën e verifikimit prej 2 (dy) viteve. Të pandehurit pastaj i është shqiptuar dënimi me ndalim të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik për 2 (dy) vite. N.Z. është liruar nga akuzat në vijim: sulmi, në kundërshti me nenin 187(2) në lidhje me paragrafin 1, në lidhje me nenin 31 të KPK-së (pika 3 e aktakuzës); dhe sulmi, në kundërshti me nenin 187(3) në lidhje me paragrafin 1, në lidhje me nenin 31 të KPK-së (pika 4 e aktakuzës).
8. **I.R.** është shpallur fajtor për veprat penale në vijim: keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshti me nenin 198(1) të KPK-së; dhe sulmi, në kundërshti me nenin 187(1) të KPK-së. Atij i është shqiptuar dënimi në bashkim me 1 (një) vit burgim me pezullim të ekzekutimit të dënimit sipas nenit 51(2) të KPK-së për periudhën e verifikimit prej 2 (dy) viteve. Të pandehurit pastaj i është shqiptuar dënimi me ndalim të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik për 2 (dy) vite. I.R. është liruar nga akuzat në vijim: sulmi, në kundërshti me nenin 187(2), në lidhje me

paragrafin 1, në lidhje me nenin 31 të KPK-së (pika 3 e aktakuzës); sulmi, në kundërshti me nenin 187(3) në lidhje me paragrafin 1, në lidhje me nenin 31 të KPK-së (pika 4 e aktakuzës); dhe keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshti me nenin 198(1) të KPK-së, në lidhje me nenin 31 të KPK-së (pika 12 e aktakuzës).

9. **J.R., N.S., Xh.H., V.K. dhe Z.S.** janë liruar nga akuzat në vijim: keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshti me nenin 198(1) të KPK-së, në lidhje me nenin 31 të KPK-së (pika 1 e aktakuzës); sulmi, në kundërshti me nenin 187(1), në lidhje me nenin 31 të KPK-së (pika 2 e aktakuzës); sulmi, në kundërshti me nenin 187(2), në lidhje me paragrafin 1, në lidhje me nenin 31 të KPK-së (pika 3 e aktakuzës); dhe sulmi, në kundërshti me nenin 187(3), në lidhje me paragrafin 1, në lidhje me nenin 31 të KPK-së (pika 4 e aktakuzës). **N.S. dhe Xh.H.** pastaj janë liruar nga akuza për keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshti me nenin 198(1) të KPK-së, në lidhje me nenin 31 të KPK-së (pika 11 e aktakuzës). **J.R., V.K. dhe Z.S.** pastaj janë liruar nga akuza për keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshti me nenin 198(1) të KPK-së, në lidhje me nenin 31 të KPK-së (Pika 12 e aktakuzës).
10. Ankesa kundër Aktgjykimit PKR 1098/13 të Gjykatës Themelore të Prishtinës të datës 18 nëntor 2015 kanë ushtruar mbrojtësi A.R., në emër të të pandehurit G.K., më 12 mars të vitit 2016, mbrojtësi N.S., në emër të të pandehurit S.S., më 10 mars të vitit 2016, mbrojtësi R.D., në emër të të pandehurit S.A., më 10 mars të vitit 2016, mbrojtësi K.P., në emër të të pandehurit N.D., më 16 mars të vitit 2016, mbrojtësi G.A., në emër të të pandehurit N.Z., më 16 mars të vitit 2016, mbrojtësja A.K., në emër të të pandehurit I.R., më 14 mars të vitit 2016, i pandehuri I.R. më 9 mars të vitit 2016, dhe prokurori më 11 mars të vitit 2016.
11. Përgjigje në ankesën e Prokurorisë Themelore të EULEX-it janë paraqitur nga mbrojtësi R.D., në emër të të pandehurit S.A., më 21 mars të vitit 2016, mbrojtësja F.B., në emër të të pandehurit N.S., më 22 mars të vitit 2016, mbrojtësja M.S.E., në emër të të pandehurit Z.S., më 23 mars të vitit 2016, mbrojtësi N.S., në emër të të pandehurit J.R., më 31 mars të vitit

2016. Prokurori ka paraqitur përgjigje në ankesat e ushtruara nga mbrojtësit dhe të pandehurit më 6 prill të vitit 2016;

12. Më 9 qershor të vitit 2016, prokurori i apelit ka paraqitur propozim.

13. Më 25 prill të vitit 2017, Gjykata e Apelit ka mbajtur seancë sipas nenit 390 të KPP-së.

II. Parashtrësit e palëve

a. Ankesat

- *Ankesa e ushtruar nga mbrojtësi A.R. në emër të të pandehurit G.K. më 12 mars të vitit 2016*

14. Mbrojtësi pretendon se aktgjykimi i kundërshtuar konsiston në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe KPK-së si dhe në vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe vendim të gabuar për dënimin me burgim dhe ndalim për të ushtruar funksione publike për 2 (dy) vite. Prandaj, mbrojtja i propozon gjykatës që ta ndryshojë aktgjykimin e kundërshtuar dhe ta lirojë të pandehurin ose ta anulojë aktgjykimin dhe lëndën ta kthejë për rigjykim.

15. Mbrojtja pretendon se aktgjykimi është në kundërshti me nenin 384(1)(11) dhe (12), në lidhje me nenin 370(7) dhe (8) të KPP-së. Dispozitivi i aktgjyimit është i pakuptueshëm dhe është në kundërshti me arsyetimin që është dhënë në aktgjykim. Mbrojtësi pastaj pretendon se Gjykata Themelore e ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike në disa pika. Mbrojtja po ashtu pretendon se aktgjykimi i Gjykatës Themelore konsiston në shkelje të ligjit penal. Si rrjedhojë e shkeljeve të procedurës penale dhe ligjit penal si dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, Gjykata Themelore i ka shqiptuar të pandehurit sanksion penal të gabuar. Pretendimet e sakta do të trajtohen në arsyetimin e këtij aktgjykimi.

- *Ankesa e ushtruar nga mbrojtësi N.S. në emër të të pandehurit S.S. më 10 mars të vitit 2016*

16. Mbrojtja pretendon se aktgjykimi i Gjykatës Themelore konsiston në shkelje të ligjit penal siç është përshkruar në nenin 385(1.4) të KPP-së. Prandaj, mbrojtja i propozon Gjykatës së Apelit që ta ndryshojë aktgjykimin e kundërshtuar dhe ose ta lirojë të pandehurin S.S. nga të gjitha akuzat, ose ta shpallë atë fajtor vetëm për veprën penale të keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshti me nenin 198(1) të KPK-së, dhe t'i anulojë dënimet e tjera. Pretendimet e sakta do të trajtohen në arsyetimin e këtij aktgjykimi.

- *Ankesa e ushtruar nga mbrojtësi R.D. në emër të të pandehurit S.A. më 10 mars të vitit 2016*

17. Mbrojtja pretendon se aktgjykimi i Gjykatës Themelore konsiston në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkelje të ligjit penal, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendim të gabuar për sanksionet penale. Prandaj, mbrojtja propozon që aktgjykimi i kundërshtuar të ndryshohet duke e liruar të pandehurin S.A. nga akuzat ose që aktgjykimi i kundërshtuar të anulohet dhe lënda të kthehet për rigjykim.

18. Mbrojtja pretendon se aktgjykimi i kundërshtuar konsiston në një numër shkeljesh të procedurës penale dhe se në të gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë. Mbrojtja pastaj pretendon se aktgjykimi i kundërshtuar konsiston në shkelje të ligjit penal. Aktgjykimi është në kundërshti me nenin 24 të KPK-së, sepse S.A. është akuzuar dhe dënuar për vepra penale të cilat ai nuk i ka kryer. Pretendimet e sakta do të trajtohen në arsyetimin e këtij aktgjykimi.

- *Ankesa e ushtruar nga mbrojtësi K.P. në emër të të pandehurit N.D. më 16 mars të vitit 2016*

19. Mbrojtja pretendon se aktgjykimi i kundërshtuar konsiston në shkelje esenciale të procedurës penale sa u përket provave, shkelje të ligjit penal, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendim të gabuar për sanksionin penal. Prandaj, mbrojtja i propozon Gjykatës së Apelit që ta anulojë aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe ta refuzojë

aktakuzën, ose ta anulojë aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe ta kthejë lëndën për rigjykim. Pretendimet e sakta do të trajtohen në arsyetimin e këtij aktgjykimi.

- *Ankesa e ushtruar nga mbrojtësi G.A. në emër të të pandehurit N.Z. më 16 mars të vitit 2016*

20. Mbrojtja pretendon se aktgjykimin i kundërshtuar konsiston në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkelje të ligjit penal, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendim të gabuar për sanksionin penal. Mbrojtja propozon që Gjykata e Apelit ta anulojë aktgjykimin e kundërshtuar dhe ta kthejë lëndën për rigjykim ose që ta ndryshojë aktgjykimin e kundërshtuar. Pretendimet e sakta do të trajtohen në arsyetimin e këtij aktgjykimi.

- *Ankesa e ushtruar nga mbrojtësi A.K. në emër të të pandehurit I.R. më 14 mars të vitit 2016*

21. Mbrojtësi deklaron se aktgjykimin i kundërshtuar konsiston në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkelje të ligjit penal, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendim të gabuar për sanksionin penal. Prandaj, mbrojtja i propozon Gjykatës së Apelit që ta ndryshojë aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe ta lirojë të pandehurin, ose ta anulojë aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe ta kthejë lëndën për rigjykim.

22. Mbrojtja pretendon se aktgjykimin konsiston në një numër shkeljesh të procedurës penale dhe se në të është vërtetuar gabimisht gjendja faktike. Pretendimet e sakta do të trajtohen në arsyetimin e këtij aktgjykimi.

- *Ankesa e ushtruar nga i pandehuri I.R. më 9 mars të vitit 2016*

23. I pandehuri pretendon se aktgjykimin i kundërshtuar konsiston në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të ligjit penal dhe vërtetim të gabuar për dënimin. Prandaj, i pandehuri i propozon

Gjykatës së Apelit që ta anulojë aktgjykimin e kundërshtuar dhe ta kthejë lëndën për rigjykim, ose ta ndryshojë aktgjykimin e kundërshtuar dhe ta lirojë të pandehurin nga të gjitha akuzat.

24. I pandehuri pretendon se ka shkelje të shumta të ligjit penal sipas nenit 386 të KPP-së. Gjykata Themelore i ka zbatuar gabimisht dispozitat ligjore dhe e ka dënuar të pandehurin në vend që ta hidhte aktakuzën; Gjykata Themelore e ka tejkalluar akuzën duke e shpallur dënimin plotësues dhe Gjykata Themelore e ka injoruar rekomandimin e Gjykatës së Apelit duke thënë se vepra penale e sulmit është konsumuar nga veprat penale të tjera. Vendimi për dënimin është marrë në kundërshti me dispozitat ligjore, sepse veprat penale që kanë të bëjnë me I.R. nuk janë provuar tej dyshimit të arsyeshëm. Pretendimet e sakta do të trajtohen në arsyetimin e këtij aktgjykimi.

- *Ankesa e ushtruar nga Prokuroria Themelore e EULEX-it më 11 mars të vitit 2016*

25. Prokurori ka ushtruar ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike sipas nenit 383(1.3), në lidhje me nenin 386 të KPP-së. Prokurori i propozon Gjykatës së Apelit që ta anulojë lirimin nga akuza të të pandehurve në vijim: S.A. dhe N.D. për veprat penale që janë përmendur në pikat 1, 2, dhe 3 të aktakuzës; J.R., V.K. dhe Z.S. për veprat penale që janë përmendur në pikat 1, 2, 3, dhe 12 të aktakuzës; N.S. dhe Xh.H. për veprat penale që janë përmendur në pikat 1, 2, 3, dhe 11 të aktakuzës; S.S. për veprën penale që është përmendur në pikën 11 të aktakuzës; dhe I.R. për veprën penale që është përmendur në pikën 12 të aktakuzës, dhe që ta ndryshojë aktgjykimin e kundërshtuar duke i shpallur fajtorë dhe duke u shqiptuar dënim adekuat.

26. Prokurori vëren se të pandehurit S.A., N.D., J.R., N.S., Xh.H., V.K. dhe Z.S. janë liruar nga veprat penale që janë përmendur në pikat 1, 2, dhe 3 të aktakuzës. Pastaj, prokurori vëren se të pandehurit S.S., N.S. dhe Xh.H. janë liruar nga vepra penale që është përshkruar në pikën 11 të aktakuzës, ndërsa të pandehurit I.R., J.R., V.K. dhe Z.S. janë liruar nga vepra penale që është përshkruar në pikën 12 të aktakuzës. Ndryshe nga përfundimet e Gjykatës Themelore, prokurori konsideron se ka argumente bindëse dhe të mjaftueshme që e arsyetojnë

aktgjykimin dënues ndaj këtyre të pandehurve. Prokurori konstaton se Gjykata Themelore i ka keqinterpretuar provat ekzistuese dhe e ka vërtetuar gabimisht ekzistimin e elementeve të bashkëkryerjes siç është përkufizuar në nenin 31 të KPK-së. Pretendimet e sakta do të trajtohen në arsyetimin e këtij aktgjykimi.

b. Përgjigjet

- *Përgjigja në ankesën e Prokurorisë Themelore të EULEX-it nga mbrojtësi N.S. në emër të të pandehurit J.R.*

27. Mbrojtja pretendon se prokurori nuk ka paraqitur ndonjë argument për të provuar se aktgjykimi i kundërshtuar është i pasaktë dhe i propozon Gjykatës së Apelit që ta hedhë ankesën e ushtruar nga prokurori dhe ta informojë të pandehurin për seancën e ardhshme.

28. Mbrojtja pretendon se prokurori nuk e ka vlerësuar si duhet institucionin e bashkëkryerjes siç është përkufizuar në nenin 31 të KPP-së dhe pajtohet me Gjykatën Themelore se vetëm prania në vendin e ngjarjes nuk mjafton për ta provuar kryerjen e veprës penale. Mbrojtja ka bërë me dije se prokurori pretendon gabimisht se i pandehuri J.R. ka qenë pjesë e të ashtuquajturit “korridor”. Bazuar në provat që i ka paraqitur M.J., mund të shihet se J.R. është larguar nga objekti së bashku me të burgosurin e parë, B.M., të cilin e ka shoqëruar V.K.. Veç kësaj, nuk ka prova për ekzistimin e të ashtuquajturit “korridor”. Më në fund, mbrojtja pretendon se Gjykata Themelore e ka vlerësuar drejt deklaratën e M.J. dhe mospërputhjet e dukshme të kësaj deklaratë.

- *Përgjigja në ankesën e Prokuroria Themelore të EULEX-it nga mbrojtësi R.D. në emër të të pandehurit S.A.*

29. Mbrojtësi i propozon Gjykatës së Apelit që ta refuzojë ankesën e prokurorit si të pabazuar dhe ta aprovojë ankesën e ushtruar nga mbrojtësi duke e liruar të pandehurin S.A. nga akuza. Mbrojtësi pretendon se ankesa nuk ka bazë ligjore, sepse i pandehuri nuk ka kryer ndonjë

vepër penale. Mbrojtja pastaj pretendon se gjykimi ka qenë i ndikuar nga motivet politike dhe etnike dhe se procedura penale nuk është zhvilluar në mënyrë profesionale.

- *Përgjigja në ankesën e Prokurorisë Themelore të EULEX-it nga mbrojtësja M.S.E. në emër të të pandehurit Z.S.*

30. Mbrojtja pretendon se Gjykata Themelore e ka vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike dhe i ka vlerësuar drejt provat që janë mbledhur, prandaj i propozon Gjykatës së Apelit që ta refuzojë ankesën e ushtruar nga prokurori dhe ta vërtetojë aktgjykimin e Gjykatës Themelore.

- *Përgjigja në ankesën e Prokurorisë Themelore të EULEX-it nga mbrojtësja F.B. në emër të të pandehurit N.S.*

31. Mbrojtja pretendon se Gjykata Themelore e ka vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike dhe i ka vlerësuar drejt provat që janë mbledhur, prandaj i propozon Gjykatës së Apelit që ta refuzojë ankesën e ushtruar nga prokurori dhe ta vërtetojë aktgjykimin e Gjykatës Themelore.

- *Përgjigja e PSRK-së në ankesat e ushtruara nga mbrojtësit dhe të pandehurit*

32. Prokurori konstaton se argumentet që janë dhënë në ankesa tashmë janë paraqitur disa herë shqyrtimit gjyqësor dhe janë trajtuar në mënyrë tejet të detajuar në fjalën përfundimtare të prokurorit dhe në ankesën e ushtruar më 11 mars të vitit 2016. Prandaj, prokurori i propozon Gjykatës së Apelit që t'i refuzojë ankesat si të pabazuara.

c. Propozimi i prokurorit të apelit

33. Prokurori i apelit pajtohet me ankesën që e ka ushtruar Prokuroria Themelore e EULEX-it dhe tregon se çështje kryesore është interpretimi i gabuar i bashkëkryerjes siç është

përkufizuar në nenin 31 të KPK-së. Prokurori i apelit argumenton se është provuar tej dyshimit të arsyeshëm se të gjithë të pandehurit kanë qenë të pranishëm në vendin e ngjarjes dhe kanë qenë pjesë e grupit të zyrtarëve policorë që kanë qenë përgjegjës për t'i sjellë të burgosurit në Gjykatën e Kundërvajtjes. Prandaj, prokurori i apelit pretendon se ata janë përgjegjës për veprën penale si bashkëkryerës dhe se këtë vepër e kanë kryer me mosveprim.

34. Prokurori i apelit pretendon se ankesat që i kanë ushtruar mbrojtësit e të pandehurve dhe vet i pandehuri janë të pabazuara. Ankesat përmbajnë një numër pretendimesh që nuk mbështeten me ndonjë argument apo arsyetim.
35. Prokurori i apelit pajtohet me vlerësimin e Gjykatës Themelore se elementet e veprave penale të sulmit dhe keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike janë të natyrave të ndryshme dhe se këto dy vepra penale nuk mund të konsiderohen si një vepër penale. Prandaj, këto pretendime të mbrojtësve të G.K., S.S. dhe N.D. duhet të refuzohen si të pabazuara. Veç kësaj, prokurori i apelit pretendon se mbrojtësit e G.K., S.A. dhe I.R. nuk japin ndonjë arsyetim të duhur se pse dispozitivi është kundërthënës dhe pretendon se këto pretendime janë të pabaza.
36. Sa i përket vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, prokurori i apelit pretendon se përshkrimi i ngjarjeve dhe marrja në pyetje e dëshmitarëve/palëve të dëmtuara gjatë shqyrtimit gjyqësor janë kryer në përputhje me dispozitat e KPP-së. Prandaj, provat materiale që i janë vënë në dispozicion Gjykatës Themelore mjaftojnë për ta vërtetuar fajësinë e të pandehurit tej dyshimit të arsyeshëm. Prokurori i apelit pretendon se Gjykata Themelore e ka vlerësuar drejt deklaratën e B.M., i cili ka dëshmuar qartë se i pandehuri N.D. e ka goditur. Prandaj, veprimet e N.D. nuk mund të cilësohen si veprime të një rëndësie të vogël. Sa i përket vlerësimit të besueshmërisë së dëshmitarëve, prokurori i apelit pretendon se Gjykata Themelore është në pozitën më të mirë për t'i vlerësuar dëshmitarët dhe deklaratat e tyre dhe se Gjykata e Apelit duhet t'ua japë një dozë besimi konstatimeve faktike të Gjykatës Themelore. Vetëm mospajtimi i mbrojtjes me konstatimet faktike nuk do të thotë se rrethanat faktike janë vlerësuar në mënyrë të gabuar.

III. Përbërja e trupit gjykues

37. Trupi gjykues ka vendosur njëzëri se, sipas nenit 3 (nenit 1A (1.4) të Ligjit (Nr. 05/L-103) për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që ndërlidhen me Mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Republikën e Kosovës (në tekstin e mëtejme “Ligji Omnibus”), që mes tjerash e ndryshon Ligjin (Nr. 03/L-053) për Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, ky rast duhet të konsiderohet si ‘rast në proces’. Kështu, gjyqtarët e EULEX-it kanë kompetencë në këtë rast. Sipas nenit 3.3 të Ligjit Omnibus, trupi gjykues përbëhet nga një shumicë e gjyqtarëve vendorë dhe kryesohet nga një gjyqtar vendor.

IV. Konstatimet e trupit gjykues

a. Pranueshmëria

38. Trupi gjykues gjen se ankesat e ushtruara nga mbrojtësi A.R. në emër të të pandehurit G.K. më 12 mars të vitit 2016, mbrojtësi N.S. në emër të të pandehurit S.S. më 10 mars të vitit 2016, mbrojtësi R.D. në emër të të pandehurit S.A. më 10 mars të vitit 2016, mbrojtësi K.P. në emër të të pandehurit N.D. më 16 mars të vitit 2016, mbrojtësi G.A. në emër të të pandehurit N.Z. më 16 mars të vitit 2016, mbrojtësja A.K. në emër të të pandehurit I.R. më 14 mars të vitit 2016, i pandehuri I.R. më 9 mars të vitit 2016, dhe prokurori më 11 mars të vitit 2016 janë të pranueshme. Ato janë ushtruar nga një person i autorizuar (neni 381(1) i KPP-së), brenda afatit ligjor (neni 380(1) i KPP-së) dhe i janë dorëzuar gjykatës kompetente (neni 374(1)(1.1) i KPP-së).

b. Trupi gjykues i Gjykatës Themelore nuk ka pasur kompetencë për ta gjykuar rastin

39. I pandehuri I.R. deklaron se aktgjykimi i Gjykatës Themelore është në kundërshti me nenin 384(1)(1.1) të KPP-së, në lidhje me nenet 21(3) dhe 25(2) të KPP-së. Aktakuza që është ngritur kundër të pandehurit nuk përmban ndonjë veprë penale që hyn në kompetencë të Departamentit për Krime Serioze. Aktakuza është dashur të ngrihej pranë Departamentit të Përgjithshëm dhe të trajtohej nga një gjyqtar i vetëm gjykues.

40. Në këtë aspekt, trupi gjykues vëren se, sipas nenit 15 (1.19) të Ligjit Nr. 03/L-199 për Gjykatat, **veprat penale kundër detyrës zyrtare që përfshijnë**, por që nuk kufizohen me keqpërdorimin e pozitës apo autoritetit zyrtar, shpërdorimin në detyrë, mashtrimin, marrjen e ryshfetit dhe ushtrimin e ndikimit si dhe veprat e ngjashme gjykohen nga Departamenti për Krime Serioze i Gjykatës Themelore. Në rastin e tanishëm, në mesin e veprave penale të tjera, të pandehurit akuzohen për keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, siç është përkrahur në nenin 198 të KPK-së.

Një nga elementet e kësaj veprë penale është se kryerësi ka vepruar në pozitën e tij ose saj zyrtare të autorizimit publik. Prandaj, kolegji konsideron se kushtet e përcaktuara në nenin 15 të Ligjit nr. 03/L-199 për Gjykatat janë përmbushur dhe çështja është shqyrtuar dhe vendosur drejt nga një trup gjykues prej 3 (tre) gjyqtarësh profesionalë, ku 1 (një) gjyqtar caktohet për ta kryesuar trupin gjykues. Rrjedhimisht, pretendimi se çështja do të duhej të vendosej nga një gjyqtar i vetëm gjykues refuzohet si i pabazuar.

c. Dispozitivi është i pakuptueshëm dhe kundërthënës

41. Mbrojtësit e G.K., S.A., N.D. dhe I.R. pretendojnë se dispozitivi është i pakuptueshëm, kundërthënës në përmbajtjen e vet dhe në arsyetimin e aktgjykimit. Formulimet nuk përmbajnë asnjë përshkrim të fakteve ose të rrethanave që do t'i përshkruanin veprat penale siç pretendohet të kryera nga të pandehurit siç kërkohet me nenin 370(4) të KPP-së. Mbrojtësi i G.K. më tej pretendon se dispozitivi në pjesët ku përshkruan veprimet e G.K. kundër M.J., I.P., B.M. dhe D.V. nuk përmban kriteret ligjore të përshkruara në nenet 365(1)(1.1), 370(4) dhe 384(1.10) të KPP-së.

42. Kolegji konsideron se dispozitivi i Aktgjykimit të Gjykatës Themelore është hartuar në pajtim me kushtet e përcaktuara në nenin 370 (3) dhe (4) në lidhje me nenin 365 të KPP-së. Dispozitivi përmban përshkrimin e plotë të veprave sipas të cilave të pandehurit janë gjetur fajtor ose liruar nga akuzat së bashku me përshkrimin e fakteve dhe të rrethanave që e tregojnë natyrën e tyre kriminale dhe zbatimin e dispozitave përkatëse të ligjit penal. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore tregon qartë rrethanat e veprës penale, jep përshkrim të qartë të çdo veprë të kryer nga secili i pandehur, se cilat vepra janë kryer në bashkëkryerje, dhe në mënyrë të saktë tregon emrat e palëve të dëmtuara.
43. Megjithatë, kolegji pajtohet me mbrojtjen se Gjykata Themelore nuk merret në mënyrë të saktë me faktet që i konsideron të vërtetuara ose jo të vërtetuara dhe provat mbi të cilat është mbështetur gjykata kur nxori aktgjykimin. Në këtë drejtim, kolegji vëren se ligjvënësi nuk e përcakton kushtin për t'i detajuar faktet e vërtetuara ose të pavërtetuara në dispozitiv. Kjo më tepër është kërkesë e arsyetimit siç paraqitet në nenin 370(7) të KPP-së. Synim i ligjvënësit në këtë drejtim është të sigurojë që dispozitivi të jetë sa më i shkurtër dhe konciz që të jetë e mundur, dhe të përshkruajë vetëm elementet e detajuara në nenin 365 të KPP-së. Aktgjykimi është një dokument kompleks që duhet të lexohet në plotësinë e tij, përfshirë këtu dispozitivin dhe arsyetimin. Dispozitivi dhe arsyetimi janë pjesë të pandashme të çdo aktgjykimi dhe pjesë të caktuara dhe/ose fjalitë e aktgjykimit nuk mund të lexohen të izoluara.
44. Prandaj, kolegji konsideron se mbrojtësi nuk ka paraqitura asnjë shkelje konkrete të neneve 365(1)(1.1), 370(4) dhe 384(1.10) të KPP-së. Pretendimet se dispozitivi është i pamjaftueshëm dhe jokonsistent më tepër lidhen me mospajtimin me sa i përket vërtetimit faktik. Kolegji vëren, se vërtetimi ndoshta në mënyrë të gabuar ose jo të plotë i gjendjes faktike nuk do të thotë automatikisht se ka shkelje esenciale të procedurës penale. Këto janë dy arsytet e ndara për një ankesë të cilat jo doemos ndërlidhen. Prandaj, pretendimet e ngritja nga mbrojtësi i G.K., S.A. dhe I.R. në lidhje me kundërthëniet në arsyetim, si dhe ndërmjet dispozitivit dhe arsyetimit refuzohen si të pabazuara.
45. Mbrojtja e G.K. tregon se dispozitivi është kundërthënës në vete pasi që ai i referohet “pikës 4” për të cilën i pandehuri u gjet fajtor dhe ndaj tij u shqiptua dënimi; megjithatë, më vonë në

aktgjykim tregohet se i pandehuri është liruar nga akuza për Pikën 4. Prandaj, mbrojtja pretendon se dispozitivi është në kundërthënie me veten.

46. Në këtë drejtim, kolegji konsideron se ky pretendim më shumë është një keqkuptim i Aktgjykimit. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore është një dokument i gjatë dhe kompleks, i cili përmban përshkrimet e veprave të 11 (njëmbëdhjetë) të pandehurve dhe 19 (nëntëmbëdhjetë) pika të aktakuzës. Kjo mund të kërkojë lexim të kujdesshëm dhe vëmendje më të madhe ndaj detajeve. Në këtë situatë të veçantë, “pika 4” nuk përkon me Pikën 4 të Aktakuzës. Veprimet e të pandehurit G.K. u ndanë në 4 pjesë mbi bazën e përshkrimit të veprave kundër 4 (katër) palëve të dëmtuara. Në fund të përshkrimit të secilës pikë, tregohet qartë pika relevante e aktakuzës. Kështu që, kolegji konsideron se aktakuza nuk është në kundërthënie me veten dhe se aty përcaktohet qartë se për cilat vepra i pandehuri është gjetur fajtor ose është liruar nga akuzat. Si rrjedhojë, pretendim i mbrojtjes refuzohet si i pabazuar.

d. Dëshmitë e palëve të dëmtuara përmes linkut të video-konferencës

47. Më tej, mbrojtja e G.K. pretendon se interesi i mbrojtjes ishte dëmtuar rëndë kur dëshmitarët si palë e dëmtuar refuzonin të paraqiteshin personalisht gjatë shqyrtimit dhe në vend të kësaj u ishte dhënë leja që të dëshmonin përmes video-lidhjes.

48. Në përgjithësi, si gjykatat vendore, ashtu edhe ato ndërkombëtare, si Gjykata Ndërkombëtare Penale, e kanë përcaktuar mjaft mirë, me rregullat e procedimit të provave ku shtjellohet lejimi i shfrytëzimit të dhënies së dëshmisë përmes video-lidhjes.¹ Në këto situata, gjykata thjesht duhet të vlerësojë nëse janë plotësuar kushtet për video-konferencë. Megjithatë, KPP-ja ekzistuese nuk e ka një rregull të qartë lidhur me procedimin e provave në video-konferenca. Prandaj, kolegji duhet të vlerësojë nëse shfrytëzimi i video-konferencës dhe përparësitë e mundshme në dëgjimin e dëshmisë së palëve të dëmtuara, gjë që përndryshe nuk do të ishin në dispozicion është i baraspeshuar kundrejt të drejtës së të pandehurve për ballafaqim. Përgjithësisht është e pranueshme se video-konferenca është në dy kahje dhe

¹ *Shih*, p.sh., Mrksic, Rasti nr. IT-95-13/1; Statuti i Romës i Gjykatës Ndërkombëtare Penale, neni 68, 17 korrik 1998, 2187, U.N.T.S. 3 (1998).

teknologjia në dispozicion në ditët e sotme janë plotësisht në përputhje me qëllimet dhe mbrojtjet që ka pasur për qëllim e drejta e ballafaqimit. Kjo teknologji i mundëson të pandehurit ta shoh dhe të shihet nga dëshmitari dhe anasjelltas, dhe siguron mundësinë e të pandehurit për marrje të tërthortë në pyetje të dëshmitarit. Kolegji thekson se këta faktorë janë elementë jetikë të të drejtës së ballafaqimit.

49. Nuk ekzistojnë rregulla që ta definojnë se në cilat situata dëshmitari ose pala e dëmtuar mund të dëgjohet përmes linkut të video-konferencës. Prandaj, është në vlerësimin e lirë të trupit gjykues të përcaktojë nëse një situatë e caktuar do të përlligjte që dëshmitari të dëshmojë përmes shfrytëzimit të teknologjisë së video-konferencës dhe ta baraspeshonte atë me efektin e mundshëm negativ të të drejtës së të pandehurve për ballafaqim.
50. Kjo çështje është ngritur dhe diskutuar në detaje gjatë shqyrtimit gjyqësor (*shih*, faqet 3 – 4 të Procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor, 24 shtator 2014, dhe faqet 8 – 12 të Procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor, 9 tetor 2014). Trupi gjykues i kishte informuar palët lidhur me shqetësimet e sigurisë të ngritura nga palët e dëmtuara dhe kishte propozuar tre opsione për ta zgjidhur çështjen. Prokurori dhe mbrojtësi u lejuan të shprehnin pikëpamjet e tyre për secilin opcion të propozuar. Më pas, trupi gjykues nxori një aktvendim ku tregonte se zgjidhja më praktike dhe e shpejtë është që palët e dëmtuara të dëgjoheshin përmes teknologjisë së video-konferencës; megjithatë dispozitat e nenit 343 të KPP-së janë të zbatueshme në rast se vide-konferenca është e pamjaftueshme për të dëgjuar një prova të caktuara (*shih*, faqe 12, Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, 9 tetor 2014).
51. Në rastin e tanishëm, palët kishin mundësinë të shprehnin pikëpamjet e tyre mbi mundësitë që t'i dëgjonin palët e dëmtuara të cilat nuk ishin paraqitur në shqyrtim për shkak të shqetësimeve të sigurisë. Për më tepër, mbrojtja nuk e kishte ngritur asnjë kundërshtim ndaj përdorimit të teknologjisë së video-konferencës. Mbrojtja vetëm i kishte ngritur shqetësimet e sigurisë në rast se dispozitat e nenit 343 të KPP-së do të ishin shfrytëzuar. Gjatë dëshmive të palëve të dëmtuara, prokuroria dhe të gjithë mbrojtësit kanë qenë në gjendje të shtronin pyetje dhe të kryenin marrje efektive të tërthortë në pyetje të të gjitha palëve të dëmtuara që dëshmuuan duke e përdorur linkun e video-konferencës. Prandaj, kolegji konstaton se çështja e dëgjimit të palëve të dëmtuara përmes përdorimit të teknologjisë së video-konferencës ishte

trajtuar në mënyrë të duhur, ishin shqyrtuar të gjitha mundësitë dhe ishin përcaktuar metodat alternative. Më tej, kolegji është i kënaqur që e drejta e të pandehurve për ballafaqim ishte garantuar në mënyrë adekuate, dhe ata kishin mundësinë e plotë për marrje të tërthortë në pyetje të palëve të dëmtuara. Prandaj, pretendimet e mbrojtjes së G.K. refuzohen si të pabazuara.

e. Shkeljet e kryera gjatë fazës hetimore

52. Mbrojtja e S.A. dhe I.R. pretendojnë se aktgjykimi i Gjykatës Themelore është në shkelje të nenit 103 të KPP-së sepse nuk i ka vlerësuar provat materiale të paraqitura gjatë procedurës paraprake. Sipas mbrojtjes, procedura penale kishte nisur për shkak të përfshirjes së politikanëve nga Beogradi. Më tej, prokuroria e kishte shkelur kushtin që të mblidhte si materialin fajësues ashtu edhe atë shfajësues duke e kërcënuar njërin nga dëshmitarët e mbrojtur që të jepte deklaratën që do t'i shkonte për shtati prokurorisë. Për këto arsye, mbrojtja pohon se aktakuza nuk do të ngritej nëse prokurori do t'i respektonte dispozitat e KPK-së dhe të KPP-së.

53. Kolegji vëren se mbrojtja ngre pretendimin se hetimi ishte ndikuar nga motive politike pa treguar ndonjë shkelje specifike ose pa dhënë ndonjë provë specifike se si hetimi ishte ndikuar nga politikanët në Beograd. Kolegji vëren se hetimi dhe shqyrtimi ishin kryer në pajtim me dispozitat e KPP-së. Aktakuza ishte konfirmua në seancën e shqyrtimit fillestar, provat ishin paraqitur gjatë shqyrtimit gjyqësor, mbrojtja ka mundur t'i sfidojë të gjitha provat e paraqitura nga prokuroria dhe t'i sjellë provat vetanake. Prandaj, kolegji konsideron se nuk ka asnjë tregues të ndërhyrjes politike ose manipulimit të dëshmitarëve, dhe pretendimet e mbrojtjes i konsideron jo meritore.

f. Mos-ofrimi i informatave të kërkuara nga mbrojtja gjatë fazës së hetimeve

54. Mbrojtja e G.K. pohon se prokuroria nuk i siguroi mbrojtjes informatat që lidheshin me kryerjen e procedurës penale.

55. Në kontekstin e procedurës penale, zbulimi i provave është përkufizuar si detyrim kushtetues i prokurorisë që t'i zbulojë dhe ta vë në dispozicion të mbrojtjes çdo material që prokuroria ka në posedim ose është siguruar nga prokuroria, e që mund të jetë relevant për rastin, i cili ose do të mund t'i ndihmonte mbrojtjes ose do ta dëmtonte prokurorinë. Ky është një detyrim kryesor në procesin e drejtësisë penale. Detyrimi i zbulimit të provave rrjedh nga e drejta te kushtetuese të të akuzuarit për gjykim në një proces të rregullt ligjor dhe me procedura të drejta.
56. Kushti i përgjithshëm i zbulimit të materialit relevant është përcaktuar në nenin 244 të KPP-së. Në nenin 245(4) të KPP-së më tej plotësohet se gjatë shqyrtimit fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues siguron që prokurori i shtetit të ketë përmbushur detyrimet që kanë të bëjnë me zbulimin e provave nga neni 244 i KPP-së. Çështja e zbulimit të provave në rastin e tanishëm ishte trajtuar me shumë hollësi gjatë shqyrtimit fillestar (*shih* Procesverbali i shqyrtimit fillestar, 28 janar 2014 dhe 4 shkurt 2014). Kryetari i trupit gjykues kishte ardhur në përfundimin se detyrimi i prokurorit për zbulimin e provave ishte përmbushur.
57. Më tej, prokurori ka disa obligime të caktuara sa i përket zbulimit të provave gjatë fazës së hetimeve. Për shembull, në nenin 138(5) të KPP-së thuhet se raporti i ekspertit i zbulohet të pandehurit apo mbrojtësit të tij. Në rastin e tanishëm, PSRK-ja i kishte informuar të gjithë të pandehurit lidhur me Raportin e ForeN.Z.ikës së TI-së të datës 14 mars 2013 me kohë. Kolegji konsideron se ky shembull tregon qartë se prokuroria e kishte respektuar obligimin për ta informuar të pandehurin sa i përket zhvillimit të hetimeve.
58. Andaj, kolegji vjen në përfundim se prokuroria qartazi e ka respektuar detyrimin për zbulimin e provave si gjatë fazës së hetimeve, dhe pas paraqitjes së aktakuzës. Prokuroria ua kishte zbuluar të pandehurve dhe mbrojtësve të gjithë materialin e mbledhur gjatë hetimeve, dhe u kishte dhënë mundësinë mbrojtësve që t'i këqyrnin informatat të cilat ishin redaktuar për shkak të masave mbrojtëse të zbatuara ndaj dëshmitarëve të caktuar (*shih* Procesverbali i shqyrtimit fillestar, 28 janar 2014 dhe 4 shkurt 2014). Të pandehurit dhe mbrojtësit e tyre kanë pasur njohuri të plotë lidhur me rastin e prokurorisë, dhe kanë qenë në pozitë të

vlerësonin rastin kundër tyre dhe ta mbronin veten e tyre. Kështu që, kolegji konsideron se pretendimi i mbrojtjes së G.K.t është pa merita, dhe rrjedhimisht refuzohet si i pabazuar.

g. Vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike

- *Standardi i shqyrtimit nga apeli*

60. Mbrojtja e S.A., N.D., N.Z. dhe I.R. pohojnë se aktgjykimi i kundërshtuar është në shkelje të nenit 7 të KPP-së, sepse Gjykata Themelore ka dështuar që në mënyrë të besueshme dhe të plotë t'i vërtetojë faktet të cilat janë të rëndësishme në marrjen e vendimit të ligjshëm. Gjykata nuk i ka marrë parasysh mospërputhjet në dëshmitë e palëve të dëmtuara e as asnjë provë të paraqitur në favor të të pandehurve. Argumentet e palëve janë të paraqitura në hollësi më poshtë.
61. Qysh në fillim, kolegji vëren se standardet e shqyrtimit në apel janë nxjerrë nga dhe, deri në njëfarë shkalle e pasqyrojnë, rolin e kufizuar të gjykatës së apelit në një sistem gjyqësor shumë-nivelesh. Si rregull i përgjithshëm, gjyqtarët e apelit kryesisht merren me korrigjimin e gabimeve ligjore të bëra nga gjykatat më të ulëta, duke zhvilluar drejtësi dhe parashtruar precedent në bazë të të cilëve do të udhëzohen rastet në të ardhmen. Për dallim nga kjo, gjyqtarëve të gjykatës themelore, u besohet roli i zgjidhjes së kontesteve faktike dhe krijimi i vërtetimeve të besueshme në lidhje me dëshminë e dëshmitarëve sepse ata i shohin dhe i dëgjojnë dëshmitarët duke dëshmuar. Gjetjeve faktike të gjyqtarin në shqyrtim u jepet respekt i madh sepse gjyqtari ka kryesuar gjatë shqyrtimit, dëgjimit të dëshmisë, dhe i kupton më së miri provat. Nën një standard të qartë të gabueshëm, nuk mjafton të tregohet se vërtetimi i fakteve ishte i diskutueshëm. Një gjykatë e apelit do të konfirmojë vërtetimin e fakteve të shqyrtimit nga gjykata, përveç nëse, mbi bazën e shqyrtimit të të gjithë shkresave, mbetet bindja e qartë dhe e fortë se është bërë gabim. Një margjinë e gjerë e nënshtimit ndaj atyre vlerësimeve ishte konfirmuar edhe nga Gjykata Supreme në rastet e mëparshme “*që t'i përmbahet vlerësimit nga trupi gjykues të besueshmërisë së dëshmitarëve të shqyrtimit që janë paraqitur personalisht para tyre dhe kanë dëshmuar personalisht para tyre. Nuk është e përshtatshme që Gjykata Supreme e Kosovës të mos e përfill vlerësimin e trupit gjykues sa i*

përket besueshmërisë së atyre dëshmitarëve përveç nëse ka bazë të fortë për ta bërë këtë.” Standardi i zbatuar nga Gjykata Supreme ishte “që të mos i prish gjetjet e shqyrtimit të gjykatës përveç se kur dëshmitë mbi të cilat është mbështetur gjykata gjatë shqyrtimit, nuk do të mund të pranoheshin nga ndonjë gjykatë e arsyeshme e faktit, ose kur vlerësimi i saj ka qenë tërësisht i gabuar”.²

62. Standardi i shqyrtimit nga apeli i vërtetimit faktik parashtrohet në nenin 386 të KPP-së. Ky nen vërteton se nuk mjafton të tregohet gabimi i pretenduar ose vërtetimi jo i plotë i faktit nga trupi gjykues. Më tepër, siç kërkohet me kodin e procedurës penale që vërtetimi i gabuar ose jo i plotë i gjendjes faktike ndërlidhet me një “fakt të rëndësishëm”, ushtruesi i ankesës duhet që po ashtu të vërtetojë se vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike në të vërtetë ka të bëjë me një fakt të rëndësishëm, d.m.th., është me rëndësi vendimtare për vendimin e marrë. Prandaj, kolegji në rastin e tanishëm do të merret me të gjitha pretendimet që ndërlidhen me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të fakteve në frymën e standardit të lartcekur të shqyrtimit.

- *Dëmet e palëve të dëmtuara nuk janë vlerësuar në mënyrë adekuate*

63. Mbrojtja e G.K., N.D. dhe N.Z. argumenton se Gjykata Themelore ka dështuar që t'i vlerësojë si duhet dëmet e pretenduara të palëve të dëmtuara dhe t'i marrë parasysht kundërthëniet në deklaratat e palëve të dëmtuara.

64. Të gjitha palët e dëmtuara kanë refuzuar të marrin trajtim mjekësor në Qendrën Mjekësore të EULEX-it; ata kanë paraqitur dokumente të trajtimit mjekësor nga Laposaviqi dhe Stacioni i Policisë në Mitrovicë 8 (tetë) deri 10 (dhjetë) ditë pasi kanë ndodhur ngjarjet e pretenduara. Më tej, pala e dëmtuar pretendon se ka pësuar dëmtim të rëndë trupor; megjithatë, mjekja ligjore e EULEX-it në raportin e saj i konfirmoi vetëm dëmtime të lehta trupore. Për më tepër, ekspertët mjeko-ligjor të EULEX-it konfirmuan se të gjitha palët e dëmtuara kishin pësuar lëndime të lehta pa pasoja të përhershme; dhe se nuk është regjistruar stres post-traumatik. Mbrojtja e G.K. argumenton se dispozitivi është në kundërtënie me deklaratat e

² Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZi 84/2009, 3 dhjetor 2009, par. 35; Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZi 2/2012, 24 shtator 2012, par. 30.

disa dëshmitarëve (N.G., J.M. dhe R.H., dhe mbrojtësve të palëve të dëmtuara B.A., G.H. dhe A.H.) të cilët dëshmuar se ata nuk kishin vërejtur ndonjë lëndim tek të ndaluarit.

65. Kolegji vëren se Gjykata Themelore nuk e ka vlerësuar dëshminë e ekspertës mjeko-ligjore të EULEX-it C.B. dhe erdhi në përfundim se për shkak të lëndimit të topitur është e mundur të konkludohet se palët e dëmtuara kanë pësuar dëmtime të lehta trupore (*shih* faqe 66 të Aktgjykimit PKR 1098/13 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, dhe faqe 6 të Procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor të datës 12 mars 2015). Dëshmitarja eksperte me shumë hollësi e kishte shpjeguar se si është e mundur të vërtetohet kur ishte shkaktuar mavijosja dhe erdhi në përfundim se kjo ka mundur të bëhet një ditë përpara ose një ditë pas ngjarjes në fjalë; megjithatë duke marrë parasysh se të dhënat mjekësore mbajnë datën 9 janar 2013, mund të vihet në përfundim se lëndimet ishin shkaktuar para 9 janarit 2013 (*shih* faqet 16-17 të Procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor të datës 12 mars 2015). Më tej, Gjykata Themelore me shumë hollësi është marrë me kredibilitetin e të dhënave mjekësore të lëshuara nga Spitali i Mitrovicës Veriore dhe erdhi në përfundim se raportet mjekësore të përpiluara nga ky spital në përgjithësi janë në pajtim me raportet e përpiluara nga mjeku i EULEX-it (*shih* faqen 66 të Aktgjykimit PKR 1098/13 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, dhe Procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të datës 12 mars 2015).

66. Kolegji vëren se opinioni i dëshmitarit ekspert gjithmonë duhet të peshohet me prova të tjera të pranishme në atë çështje. Në çështjen e tanishme, duket se për dallim nga konkluzioni i ekspertës së mjekësisë ligjore dhe dëshmitarëve të mbrojtjes, palët e dëmtuara kanë pretenduar se kanë pësuar lëndime të rënda. Megjithatë, përshtypja e përgjithshme është se pesha dëshmuese që i është dhënë nga Gjykata Themelore opinionit të ekspertit lidhej drejtpërdrejt me mundësinë e vërtetimit të dëshmisë së dëshmitarit ekspert me provat e tjera të paraqitura në këtë rast, veçanërisht, deklaratat e mjekut të EULEX-it, raporti mjekësor i Spitalit të Mitrovicës Veriore, dhe deklaratat e dëshmitarëve (*shih* faqet 66 dhe 98-99 të Aktgjykimit PKR 1098/13 të Gjykatës Themelore në Prishtinë). Si rrjedhojë, kolegji vjen në përfundim se Gjykata Themelore ka ardhur në përfundimin e vetëm logjik se palët e dëmtuara kanë pësuar lëndime të lehta rreth kohës së ngjarjeve të pretenduara. Lëndimet e rënda të pretenduara u refuzuan si të pavërtetuara nga Gjykata Themelore (*shih* faqen 104 të

Aktgjykimit PKR 1098/13 të Gjykatës Themelore në Prishtinë). Më tej, duket se palët në ankesën e tyre janë të një mendimi me gjetjet e Gjykatës Themelore, në veçanti se palët e dëmtuara kishin pësuar lëndime të lehta. Prandaj, në mungesë të ndonjë shkelje të pretenduar, kolegji i refuzon si të pabazuara pretendimet që kanë të bëjnë me vlerësimin e lëndimeve.

- *Gjykata Themelore nuk është marrë me kundërthëniet në deklaratat e palëve të dëmtuara*

67. Kur e ka bërë vlerësimin e saj, Gjykata Themelore pikësisht është mbështetur në deklaratat e dhëna nga 9 palë të dëmtuara, 3 (tre) dëshmitarë anonimë, eksperti i mjekësisë ligjore, 10 (dhjetë) dëshmitarë të tjerë të sjellë nga PSRK, 10 (dhjetë) dëshmitarë janë sjellë nga mbrojtja dhe nga të pandehurit (*shih* faqet 40-85 të Aktgjykimit PKR 1098/13 të Gjykatës Themelore në Prishtinë). Më tej, Gjykata Themelore mori në konsideratë incizimet e kamerave. Gjykata Themelore erdhi në përfundim se deklaratat e palëve të dëmtuara në përgjithësi janë të besueshme. Rrëfimet e tyre gjerësisht janë të ngjashme sa u përket çështjeve kryesore në këtë rast. Mospërputhje kanë qenë të vogla dhe kanë rrjedhur nga fakti se ata kanë kaluar nëpër një përvojë traumatike (*shih* faqen 98 të Aktgjykimit PKR 1098/13 të Gjykatës Themelore në Prishtinë).

68. Të gjithë avokatët mbrojtës, për dallim nga përfundimi i Gjykatës Themelore, pohojnë se deklaratat e palëve të dëmtuara janë mospërputhëse dhe të pabesueshme. Deklaratat janë kundërthënëse dhe do të duhej të konsideroheshin të papranueshme.

69. Mbrojtja e S.A. vë në pah se B.M. ka deklaruar se gjatë gjithë vozitjes deri te Gjykata për Kundërvajtje ai e ka pasur kokën teposhtë dhe nuk e kishte parë fytyrën e shoferit; megjithatë, prokurori e kishte manipuluar këtë deklaratë për ta mbështetur rastin e vet. Në lidhje me deklaratën e D.V., mbrojtja e S.A. vëren se për dallim nga kjo deklaratë, furgoni me të cilin ai ishte dërguar te Gjykata për Kundërvajtje nuk kishte radio ose ndonjë pajisje tjetër për muzikë. Mbrojtja e N.D. po ashtu pretendon se deklarata e D.V. është kundërthënëse dhe duhet të konsiderohet e papranueshme. Në veçanti, D.V. deklaroi se personi i dytë i cili e shoqëroi atë deri në tualet kishte një armë të shkurtër, gjersa sipas raporteve zyrtare të policisë N.D. i ishte caktuar një armë me tytë të gjatë.

70. Mbrojtja e N.Z. pretendon se i pandehuri u gjet fajtor mbi bazën e deklaratave të palës së dëmtuar I.P., e cila ishte përdorur si e pranueshme në shkelje të nenit 262(1) to (4) të KPP-së. Mbi bazën e kësaj deklarate, I.P. thjesht e kishte njohur të pandehurin por nuk tregoi për ndonjë abuzim ose keqtrajtim të kryer nga i pandehuri.
71. I pandehuri I.R. pretendon se Gjykata Themelore në mënyrë të gabuar e kishte vërtetuar gjendjen faktike në lidhje me faktin se i pandehuri e kishte goditur të ndaluarin B.M.1. Deklarata e B.M.1 nuk është e qartë; ai nuk jep detaje në lidhje me goditjen, kur kishte ndodhur, dhe nëse ai ishte goditur në furgon apo gjersa ai po shoqërohej. I pandehuri pretendon se asnjëri nga dëshmitarët nuk e ka konfirmuar se ai ishte në furgon ose se ai e kishte goditur dikë. Mbrojtja e I.R. pretendon se deklaratat e palës së dëmtuar B.M., D.T. dhe D.V. të dhëna në këtë rast janë kundërthënëse dhe jo logjike.
72. Në fund, mbrojtja e S.A. dhe I.R. pretendojnë se ka kundërthënie në dëshmitë e dhëna nga palët e dëmtuara gjatë procedurës penale në Gjykatën për Kundërvajtje dhe përmes video-lidhjes në këto procedura penale. Mbrojtja e vë në pah se asnjëri nga palët e dëmtuara nuk ka raportuar ndonjë sjellje e pahijshme nga zyrtarët policorë gjatë procedurave në Gjykatën për Kundërvajtje.
73. Kolegji vëren se Gjykata Themelore tashmë ka hudhur pjesë të deklaratave të palëve të dëmtuara të cilat ishin të mjegullta në lidhje me përshkrimin e kryerësve specifikë dhe veprimeve specifike. Për shembull, vetëm pjesët e deklaratës së I.P. ku ai i kishte njohur të pandehurit S.S., N.Z. dhe G.K. u konsideruan si të vërtetuara (*shih* faqe 102 të Aktgjykimit PKR 1098/13 të Gjykatës Themelore në Prishtinë). Pjesët e deklaratës së B.M. në të cilën ai nuk ka mundur t'i njihë zyrtarët policorë që ishin në furgon dhe të cilët po e rrihnin atë, qartazi u refuzuan nga Gjykata Themelore. Megjithatë, pjesë të deklaratës ku B.M. qartazi e njohu S.A. si shofer dhe i cili ia kishte drejtuar armën në gjurin e tij, u konsideruan si të besueshme dhe të vërtetuara nga deklaratat e dëshmitarëve B.M.1 dhe D.V. (*shih* faqet 95 dhe 105 të Aktgjykimit PKR 1098/13 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, dhe faqe 43 të Procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor të datës 3 dhjetor 2014). Kolegji konsideron se Gjykata Themelore i kishte trajtuar në shumë hollësi deklaratat e palës së dëmtuar D.V. në lidhje me rrahjen në tualetin e Gjykatës për Kundërvajtje, dhe erdhi në përfundim se D.V. qartazi i

njohu N.D. dhe G.K. si persona të cilët e rrahën atë në tualetin e Gjykatës për Kundërvajtje (*shih* faqet 95-96 dhe 104 të Aktgjykimit PKR 1098/13 të Gjykatës Themelore në Prishtinë). Më tej, Gjykata Themelore qartazi e vërtetoi se B.M.1 ishte goditur nga I.R. (*shih* faqe 96 të Aktgjykimit PKR 1098/13 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, dhe faqe 38 të Procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor të 24 tetorit 2014).

74. Më tej, Kolegji vëren se Gjykata Themelore ishte i ndërgjegjshëm për kundërthëniet ndërmjet deklaratave të palëve të dëmtuara në këtë shqyrtim dhe deklaratave të dhëna në Gjykatën për Kundërvajtje. Domethënë, palët e dëmtuara nuk e raportuan incidentin gjatë procedurave në Gjykatën për Kundërvajtje. Gjykata Themelore erdhi në përfundim se palët e dëmtuara dhanë shpjegime të arsyeshme se pse ata i kishin ndryshuar rrëfimet e tyre, dhe deklaratat e tyre i konsideroi të besueshme dhe të mbështetshme duke pasur parasysh se ato u vërtetuan nga dëshmitarë të tjerë si J.D., C.B., murgesha I.P. dhe mjekja e mjekësisë ligjore C.B. (*shih* faqet 42, 44, 60, 64, 98-99 të Aktgjykimit PKR 1098/13 të Gjykatës Themelore në Prishtinë).
75. Kolegji rikujton që Gjykata Themelore ka fuqi të plotë diskrecionale në përcaktimin e peshës dhe kredibilitetit të duhur që duhet t'i jepet dëshmisë së një dëshmitari. Ky vlerësim bazohet në një numër faktorësh, duke përfshirë sjelljen e dëshmitarit në gjykatë, rolin e tij në ngjarjet në fjalë, besueshmërinë dhe qartësinë e dëshmisë së tij, nëse ka kundërthënie ose mospërputhje në deklaratat e tij të më pastajme ose midis dëshmisë së tij dhe provave të tjera, ndonjë shembulli të mëparshëm të dëshmisë së rreme, ndonjë motivi për të gënjer, si dhe përgjigjet e dëshmitarit gjatë marrjes në pyetje.
76. Shqyrtimi i Aktgjykimit të Gjykatës Themelore dhe procesverbali i gjykimit siç është detajuar më lart pasqyron se ekzistojnë disa kundërthënie ndërmjet rrëfimeve të palëve të dëmtuara. Për dallim nga parashtrimet e të gjithë avokatëve mbrojtës, këto kundërthënie janë përgjithësisht të vogla dhe nuk vënë në dyshim vendimin e Gjykatës Themelore për t'u mbështetur në rrëfimet e palëve të dëmtuara. Më tej, kolegji rikujton se Gjykata Themelore e ka përgjegjësinë kryesore për të zgjidhur çdo mospërputhje që mund të lind brenda ose ndërmjet dëshmimeve të dëshmitarëve. Është në diskrecionin e Gjykatës Themelore ta vlerësojë

çdo mospërputhje të tillë, të konsiderojë nëse provat e marra si tërësi janë të mbështetshme dhe të besueshme, dhe të pranojë ose refuzojë veçoritë themelore të provave. Më tej, kolegji rikujton se vërtetimi mund të ekzistojë edhe kur disa detaje dallojnë ndërmjet dëshmive, me kusht që asnjë dëshmi e besueshme të mos i përshkruajë faktet në fjalë në një mënyrë që nuk është në përputhje me përshkrimin e dhënë në një dëshmi tjetër të besueshme.³ Për më tepër, vërtetimi nuk kërkon që rrëfimet e dëshmitarëve të jenë identike në të gjitha aspektet pasi që “ç[do] dëshmitar paraqet atë që ai e ka parë nga pikëpamja e tij në kohën e ngjarjeve, ose sipas mënyrës se si ai i ka kuptuar ngjarjet e treguara nga të tjerët”.⁴ Por, pyetja kryesore më shumë është nëse dy ose më shumë rrëfime të besueshme janë të papajtueshme.

77. Andaj në pajtim me këtë, kolegji arrin në përfundimin se Gjykata Themelore i ka trajtuar në mënyrë korrekte mospërputhjet në deklaratat e të dëmtuarve dhe e konfirmon analizën e Gjykatës Themelore se palët e dëmtuara ishin në gjendje t’i njihnin të pandehurit; rrëfimet e tyre në shumicë u vërtetuan nga deklaratat e palëve të tjera të dëmtuara dhe dëshmitarët. Kolegji rikujton se nuk është një gabim juridik në vetvete për të pranuar dhe për t’u mbështetur në prova që nuk janë në përputhje me deklaratën paraprake ose provat e tjera. Gjykata Themelore e ka diskrecionin që të pranojë dëshminë e një dëshmitari, pavarësisht mospërputhjeve ndërmjet dëshmive të cekura dhe deklaratave të tij të mëparshme. Megjithatë, Gjykata Themelore duhet të marrë në konsideratë çdo shpjegim të ofruar për mospërputhje të tilla gjatë përcaktimit të vlerës provuese të provave. Sa u përket mospërputhjeve ndërmjet deklaratave të dëshmitarëve gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe procedurave në Gjykatën për Kundërvajtje, kolegji vëren se gjatë marrjes në pyetje dhe marrjes së tërthortë në pyetje, palët e dëmtuara i shpjeguan arsyet e kundërthënive dhe treguan se kjo kryesisht ishte për shkak të frikës. Prandaj, sipas opinionit të kolegjit, mbrojtja nuk ka treguar se ishte e paarsyeshme që të pranoheshin dëshmitë e palëve të dëmtuara për shkak të mospërputhjeve të pretenduara me deklaratat e dhëna gjatë procedurës në Gjykatën për Kundërvajtje.

78. Më tej, kolegji nuk është i bindur se mospërputhjet paraqesin një dështim të tillë për të përshkruar me saktësi armën që mbante një nga të pandehurit ose radioja në veturë, nga D.V.

³ TPNJ, LUKIĆ & LUKIĆ (IT-98-32/1-A), Aktgjykimi i Apelit - 04.12.2012, paragrafi 112.

⁴ TPNR, MUNYAKAZI Yussuf (ICTR-97-36A-A), Aktgjykimi i Apelit - 28.09.2011, paragrafi 103.

do të kërkonte që e gjithë dëshmia e dëshmitarit të shpallej si jo e besueshme. Është vërtetuar mirë se gjykatat e shkallës së parë kanë diskrecionin për të pranuar disa, por që të hedhin poshtë pjesët e tjera të dëshmisë së dëshmitarit. Prandaj, kolegji konsideron se mbrojtësi nuk ka demonstruar se vlerësimi i Gjykatës Themelore është i paarsyeshëm. Andaj, pretendimet në lidhje me kundërthëniet ndërmjet deklaratave të dëshmitarëve dhe besueshmëria e tyre refuzohen si të pabazuara.

- *Gjykata Themelore nuk i ka vlerësuar saktë provat në dobi të të pandehurve*

79. Mbrojtja e G.K. pretendon se nuk ka dëshmi se G.K. kishte shoqëruar M.J. ose e kishte keqtrajtuar atë, apo se G.K. e kishte goditur I.P. me duart e tij. I pandehuri G.K. ishte armatosur me armë të gjatë dhe ishte caktuar për vëzhgim të jashtëm. Nga provat e paraqitura në këtë rast, domethënë në video-regjistrimet, është e qartë se G.K. thjesht e vëzhgonte situatën dhe nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim ndaj të burgosurve. Në lidhje me veprimet ndaj B.M., mbrojtja e G.K. pohon se i pandehuri nuk ishte në gjendje t'i bënte veprimet e përshkruara në të njëjtën kohë; se ai nuk kishte "pistoletë" siç tregohet në dispozitiv; dhe se nuk ka dëshmi në shkresat e lëndës që të tregonin se G.K. e ka sulmuar, frikësuar ose kërcënuar ndonjërin me armë. Mbrojtja e G.K. pohon se Gjykata Themelore qëllimisht nuk e përshkruan lëvizjen e automjeteve, drejtimin, shpejtësinë dhe kohëzgjatjen e udhëtimit. Për më tepër, të ndaluarit B.M., B.M.1, D.V. dhe të tjerët, dëshmuar se G.K. për herë të parë e takuan vetëm në automjetin Mercedes, me targa të policisë 413-01. Më tej, mbrojtja e G.K. pohon se në lidhje me Pikat 17 dhe 18 të Aktakuzës, Gjykata Themelore nuk mori parasysh se nuk ishte kryer abuzim ndaj D.V.; G.K. në mënyrë korrekte e kishte zbatuar kërkesën e të ndaluarve për përdorimin e banjës.

80. Në veçanti, Gjykata Themelore deklaron se i pandehuri S.A. e shoqëroi të burgosurin B.M. nga recepcioni i Qendrës së Ndalimit deri te automjeti, ndërsa vetë i paraburgosuri dëshmoi se i pandehuri nuk e kishte shoqëruar deri te automjeti. Më tej, nuk u vërtetua se pse i pandehuri S.A. e kishte drejtuar armën në mënyrë specifike në gjurin e B.M. apo se si i pandehuri kishte mundur ta rrihte B.M. dhe të voziste automjetin në të njëjtën kohë.

81. Trupat gjykues e kanë për detyrë të vërtetojnë fajësinë ose pafajësinë e të akuzuarit dhe duhet ta bëjnë këtë në dritën e tërësisë së provave të pranuar në procesverbal. Në pajtim me nenin 370 (7) të KPP-së, Gjykata Themelore në vendimin e saj të arsyetuar duhet të deklarojë në mënyrë të qartë dhe shteruese se cilat fakte i konsideron të vërtetuara dhe jo të provuara, si dhe arsyet për këtë. Në veçanti, nga një Gjykatë Themelore kërkohet të bëjë të gjeturat mbi ato fakte që janë thelbësore për vërtetimin e fajit për një pikë të caktuar të aktakuzës. Mungesa e ndonjë konstatimi relevant ligjor në një aktgjykim gjyqësor gjithashtu përbën dështim të qartë për të dhënë një opinion të arsyetuar. Një opinion i arsyetuar në aktgjykimin gjyqësor është thelbësor për lejimin e një ushtrimi kuptimplotë i të drejtës së ankesës nga palët dhe i mundëson Gjykatës së Apelit që t'i kuptojë dhe shqyrtojë gjetjet e Gjykatës Themelore si dhe vlerësimin nga ana e saj të provave.
82. Kolegji e përsërit analizën e tij për kredibilitetin e deklaratave të palëve të dëmtuara, siç janë detajuar në kapitullin e mëparshëm dhe thekson se Gjykata Themelore kishte diskrecion të gjerë për të peshuar deklaratat e palëve të dëmtuara kundrejt deklaratave të të pandehurve. Peshon deklaratat e palëve të dëmtuara ndaj deklaratave të pandehurve. Gjykata Themelore e ka për obligim të vlerësojë të gjithë faktorët relevant dhe të shqyrtojë me kujdes të gjitha rrethanat në të cilat është ofruar. Për derisa vlerësimi i një faktori provues në një vakum mund të mos e vërtetojë një çështje thelbësore, pesha e të gjitha provave relevante të marrë së bashku mund të dëshmojnë bindshëm të njëjtën çështje përtej dyshimit të bazuar.
83. Duke iu kthyer pretendimeve specifike, trupi gjykues vëren se mbrojtja e S.A. pretendon se B.M. asnjëherë nuk ka dëshmuar që S.A. e ka shoqëruar për tek makina. Trupi gjykues vëren se kjo është në linjë me konstatimet e cekura në aktgjykimin e Gjykatës së Shkallës së Parë ku S.A. ishte shpallur fajtor për veprime e ndërmarra kundër B.M. brenda automjetit (shih faqet 10 dhe 95 të Aktgjykimit PKR 1098/13 të Gjykatës Themelore në Prishtinë). Në mungesë të ndonjë kundërthënieje të dukshme, pretendimet e mbrojtjes prandaj refuzohen si të pabazuara.
84. Më tej, deklarata e G.K. se ai ishte caktuar thjeshtë për ta vëzhguar perimetrin dhe nuk e kishte sulmuar asnjërin nga palët e dëmtuara është në kundërthënie me deklaratat e palëve të

dëmtuara dhe dëshmitarëve tjerë. Vlerësimi i fajësisë së G.K. është rezultat i një vlerësimi kompleks të të gjitha provave të paraqitura në lidhje me atë të pandehur. Trupi gjykues konsideron se Gjykata Themelore në mënyrë të drejtë e ka vlerësuar shumën e provave dhe me kujdes i ka marrë parasysh kundërthëniet që vërehen në deklaratat e palëve të dëmtuara. Gjykata Themelore më tej ka vlerësuar me kujdes pjesët e deklaratës së palëve të dëmtuara ku identifikimi i të pandehurit nuk ka qenë i mjaftueshëm dhe i ka refuzuar ato pjese si jo të dëshmuara. Prandaj, sipas mendimit të Trupit gjykues, Gjykata Themelore me kujdes e ka përmbushur detyrën e vet në ofrimin e një vendimi të arsyetuar dhe vlerësimin e të gjitha provave të paraqitura në rast. Në mungesë të ndonjë konstatimi të kundërt, vendimi i Gjykatës Themelore që në fund të mbështetet mbi provat kumulative të palëve të dëmtuara, provat e të cilave kanë kërkuar vërtetime, pasqyron këmbënguljen e Gjykatës Themelore që, të marrë si tërësi, provat ishin mjaftueshëm të besueshme.

85. Standardi “përtej dyshimit të bazuar” tregon se provat vërtetojnë një pikë të posaçme dhe është përtej dyshimit se ndonjë alternativë e arsyeshme është e mundur.” Kërkohej që Gjykata Themelore të jetë e kënaqur se nuk ekziston asnjë shpjegim tjetër të provave përpos fajësisë së të pandehurit. Trupi gjykues me kujdes ka shqyrtuar provat e paraqitura përkitazi me fajësinë e G.K. dhe konstaton se Gjykata Themelore ka arritur në konstatimin e vetëm të mundur logjik. Trupi gjykues konstaton se Gjykata Themelore në mënyrë të drejtë ka interpretuar deklaratat e palëve të dëmtuara dhe i ka peshuar me kujdes ato në raport me deklaratën e dëshmitarit. Trupi gjykues në mënyrë të plotë miraton dhe pohon analizën e Trupit gjykues, prandaj konsideron se mbrojtja nuk ia ka dalë të tregojë ndonjë gabim në vërtetimin e fakteve. Kjo bazë e ankesës hidhet poshtë si e pabazuar.

- Mos vlerësimi i dëshmive në lidhje me “korridorin”

86. Prokuroria vëren se të pandehurit S.A., N.D., J.R., N.S., Xh.H., V.K. dhe Z.S. ishin shpallur të pafajshëm për veprat penale siç ceken në Akuzat 1, 2 dhe 3. Prokuroria pretendon se Gjykata Themelore ka gabuar në vërtetimin e gjendjes faktike duke mos vërtetuar se të gjithë shtatë të pandehurit në një moment të caktuar ishin pjesë e “korridorit” të oficerëve të NJSO përgjatë shkallëve ose/dhe ka udhëhequr të paktën njërin nga palët e dëmtuara përgjatë këtij

“korridorit” dhe rrjedhimisht ka marrë pjesë apo ka kontribuar në mënyrë thelbësore në veprën penale të Keqtrajtimit dhe Sulmit.

87. Prokuroria në vazhdim pretendon se Gjykata Themelore ka injoruar deklaratat e dhëna nga këta shtatë të pandehur gjatë fazës paraprake dhe gjatë gjykimit, dhe nuk ka paraqitur asnjë arsytim sipas Neneve 123 (5), 261 (1) dhe 262 (2) të KPP se pse këto deklaratat nuk ishin marrë parasysh. Të gjithë të burgosurit e kanë pranuar se ata janë shoqëruar nga së paku një i burgosur përmes “korridorit”. Kjo ishte konfirmuar nga deklaratat e palëve të dëmtuara. Ky informacion e ka dëshmuar se secili i pandehur e ka marrë së paku një të burgosur, e ka mbajtur me forcë përmes shkallëve duke i lejuar të pandehurve të tjerë të përdorin dhunën.
88. Sipas Prokurorisë, Gjykata Themelore nuk ia ka dalë të vlerësojë deklaratat paraprake të dhëna nga tre dëshmitarë anonim. Gjykata nuk e ka diskutuar besueshmërinë e këtyre dëshmitarëve ose nuk i ka vërtetuar dëshmitë e tyre me provat e tjera. Të tre dëshmitarët anonim e kanë konfirmuar “korridorin” e oficerëve të NJSO si dhe keqtrajtimin dhe abuzimin e të burgosurve derisa po shoqëroheshin përmes këtij “korridorit”. Prokuroria pretendon se besueshmëria e këtyre dëshmitarëve nuk dyshohet. Ata kanë dhënë një dëshmi të rrjedhshme dhe të saktë pa kundërthënie.
89. Prokuroria pretendon se nuk është e qartë se pse Gjykata Themelore ka thënë se video regjistrimet nga kamerat në parking nuk janë të qarta.
90. Gjatë vlerësimit të ekzistimit të “korridorit”, Gjykata Themelore ka marrë parasysh deklaratat e palëve të dëmtuara, deklaratat e 3 (tre) dëshmitarëve anonim dhe regjistrimet e kamerës (shih faqet 64-65, 97, 100-102 dhe 105 të Aktgjykimit PRK 1098/13 të Gjykatës Themelore në Prishtinë). Në kundërshtim me pretendimet e Prokurorisë, Gjykata Themelore ka marrë parasysh se palët e dëmtuara D.S., I.S., B.M.1, I.P., M.J., M.P. dhe B.M. nuk ishin në gjendje për të identifikuar asnjërin nga të pandehurit që ishin pjesë e “korridorit” dhe se dëshmitë e tyre për sa i takon numrit të të pandehurve që ishin pjesë e “korridorit” dallon dukshëm (shih faqet 41, 43, 47, 50-51, 57-59, 62, 100-102 dhe 105 të Aktgjykimit PKR 1098/13 të Gjykatës Themelore në Prishtinë). Më tej, Gjykata Themelore ka marrë parasysh deklaratat e 3

dëshmitarëve anonim në lidhje me “korridorin”. Në këto deklaratat asnjëri nga dëshmitarët anonim nuk ishin në gjendje ta identifikonin asnjërin nga të pandehurit që ishin pjesë e “korridorit” (shih faqet 64-65 të Aktgjykimit PRK 1098/13 të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Procesverbalin e Gjykimit kryesor, datë 16 prill 2015). Në lidhje me regjistrimet e kamerës, Gjykata Themelore ka marrë parasysh cilësinë e dobët të video regjistrimit dhe ka konstatuar se nuk është i mundur identifikimi i të pandehurve përtej dyshimit të arsyeshëm. Gjykata Themelore në vazhdim tregon se regjistrimet mund të përdoren për t’iu ndihmuar pjesëmarrësve që ti kujtojnë ngjarjet pasi që disa nga palët e dëmtuara ishin në gjendja ta njihnin veten (shih faqet 45, 50 dhe 97 të Aktgjykimit PRK 1098/13 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, dhe 25-26 të Procesverbalit të Gjykimit Kryesor, datë 23 tetor 2014).

91. Trupi gjykues nuk pajtohet me pretendimet e Prokurorisë se vlerësimi i provave i Gjykatës Themelore është i paarsyeshëm dhe ka mungesë argumentimi. Gjykata themelore në mënyrë të duhur ka shpjeguar se deklaratat e palëve të dëmtuara dhe të dëshmitarëve anonim janë mjaftueshëm të besueshme. Trupi gjykues vëren se në kundërshtim me pretendimet e Prokurorisë, Gjykata Themelore nuk i ka refuzuar deklaratat e palëve të dëmtuara, të dëshmitarëve anonim, dhe regjistrimet e kamerave sipas Neneve 123 (5), 261 (1) dhe 262 (2) të KPP. Gjykata Themelore ka konsideruar se pjesët e deklaratave të dëshmitarëve ku ata kanë dëshmuar në lidhje me “korridorin” nuk dëshmon përtej dyshimit të arsyeshëm kush ka qenë pjesë e “korridorit” pasi që asnjëri nga palët e dëmtuara apo dëshmitarëve nuk ishte në gjendje ti identifikonte të pandehurit (shih faqen 109 të Aktgjykimit PRK 1098/13 të Gjykatës Themelore në Prishtinë). Edhe pse arsyetimi i Gjykatës Themelore vazhdon përgjatë disa faqeve në kapituj të ndryshëm të Aktgjykimit, është e qartë se Gjykata Themelore e ka konsideruar si të dëshmuar se palët e dëmtuara ishin shoqëruar përgjatë të ashtu quajturit “korridor” dhe ishin rrahur gjatë kësaj kohe.

92. Trupi gjykues konsideron se Prokuroria nuk ka treguar asnjë bazë të vlerësimit të gabuar apo jo të plotë të regjistrimit të kamerave të bërë nga Gjykata Themelore. Së pari, Gjykata Themelore nuk i ka shpallur regjistrimet e kamerave si të papranueshme. Gjykata Themelore ka treguar se për shkak të cilësisë së dobët të videos, kjo provë mund të përdoret vetëm si

masë për ti ndihmuar palët e dëmtuara dhe dëshmitarët në deklaratat e tyre. Regjistrimi i kamerës ishte konsideruar si relevant për rastin dhe ishte përdorur në masë të madhe gjatë marrjes në pyetje të palëve të dëmtuara (shih faqet 25-26 të Procesverbalit të Gjykimit kryesor, datë 23 tetor 2014). Më tej, Gjykata Themelore i ka marrë në konsideratë video regjistrimit kur ka vendosur për sa i takon veshmbathjes së të pandehurve (shih faqet 107 të Aktgjykimit PKR 1098/13 të Gjykatës Themelore në Prishtinë). Një nga pikat kyçe në vlerësimin e video regjistrimit është se videoja në mënyrë të saktë tregon skenën e krimit. Në rastin aktual, palët e dëmtuara nuk ishin në mundësi për të njohur dëshmitarët e treguar në regjistrime. Prandaj, duke ndjekur parimin in dubio pro reo, Gjykata Themelore në mënyrë të drejtë ka konstatuar se në rast të cilësisë së dobët të imazheve, video regjistrimi mund të përdoret vetëm për ti ndihmuar palët e dëmtuara dhe dëshmitarët për ti kujtuar detajet.

93. Trupi gjykues sërish rikujton se bie brenda përgjegjësisë së Gjykatës Themelore të vlerësojë shumën e provave dhe për të përcaktuar nëse Prokuroria ka përmbushur obligimin e saj për të dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm se të pandehurit S.A., N.D., J.R., N.S., Xh.H., V.K. dhe Z.S. ishin pjesë e të ashtu quajturit “korridor”. Gjykata Themelore ka konsideruar se asnjëri nga palët e dëmtuara nuk ishte në gjendje për ta njohur asnjërin nga policët që mund të kenë qenë pjesë e “korridorit”. Mungesa e identifikimit të kryesit është një çështje kryesore madhore në vendosjen e dyshimit të arsyeshëm mbi fajësinë e të pandehurve. Prandaj, Trupi Gjykues konsideron se Prokuroria nuk ka treguar se vlerësimi i Gjykatës Themelore të provave në lidhje me ekzistimin e “korridorit” është i paarsyeshëm.

- Mos vlerësimi i deklaratave të palëve të dëmtuara në lidhje me Akuzat 11 dhe 12

94. Prokuroria vëren se të pandehurit S.S., N.S. dhe Xh.H. ishin shpallur të pafajshëm për veprën penale siç shpjegohet në Akuzën 11 derisa i pandehuri I.R., J.R., V.K. dhe Z.S. ishin shpallur të pafajshëm për veprën penale siç përshkruhet në Akuzën 12.

95. Në lidhje me Akuzën 11, Prokurori pretendon se Gjykata Themelore nuk i ka vlerësuar dëshmitë e viktimave të vendosura në Mercedes me tabela Police 288-01. Në këtë drejtim, palët e dëmtuara I.P., M.P., D.S. dhe I.S. kanë dëshmuar në detaje se sulmi dhe keqtrajtimi ka

vazhduar në automjet gjatë gjithë rrugëtimit nga Qendra e Paraburgimit deri në Gjykatën për Kundërvajtje. Të gjitha viktimat kanë dëshmuar se ata ishin në pozita të përkulura me mundësi shumë të kufizuara për ta parë njëri tjetrin. Dëshmitë e tyre vërtetohen në tërësi me provat e tjera dhe duhen konsideruar si të besueshme.

96. Në lidhje me Akuzën 12, Prokuroria pretendon se Gjykata Themelore nuk i ka marrë në konsideratë dëshmitë e të pandehurve I.R., J.R., V.K. dhe Z.S. dhe nuk e ka vlerësuar drejtë dëshminë e viktimës M.J.. Pala e dëmtuar ka theksuar se ai ishte sulmuar gjatë gjithë rrugës nga Qendra e Paraburgimit deri në Gjykatën për Kundërvajtje kurse Gjykata Themelore ka konstatuar gabimisht se pala e dëmtuar ishte sulmuar kur automjeti nuk ishte në lëvizje në parking. E tërë dëshmia e palës së dëmtuar ishte e qëndrueshme dhe nuk kishte kundërthënie. Dëshmia vërtetohet me prova të tjera dhe kështu nuk ka dyshim se të katër të pandehurit e kanë sulmuar dhe keqtrajtuar M.J. në automjetin Toyota, me tabela Police 293-01 gjatë shoqërimit nga Qendra e Paraburgimit deri në Gjykatën për Kundërvajtje. Më tej, pala e dëmtuar po ashtu ka identifikuar pozitivisht J.R.. Procesi i identifikimit ishte ndjekur në mënyrë strikte në pajtim me Nenin 12 të KPP dhe nuk ka rëndësi që identifikimi ishte bërë gjatë fazës paraprake.

97. Trupi gjykues ri përsërit se në kundërshtim me pretendimin e Prokurorit, Gjykata Themelore nuk i ka shpallur deklaratat e palëve të dëmtuara I.P., M.P., D.S. dhe I.S. si krejtësisht të besueshme. Pranueshmëria, besueshmëria dhe vlerësimi i kundërthënieve të deklaratave të palëve të dëmtuara tashmë janë adresuar në paragrafët 75-77 të aktgjykimit aktual. Gjykata Themelore e ka një mundësi për ti shpallur pjesë të deklaratës si të besueshme dhe pjesë të tjera si jo të besueshme. Gjykata Themelore zbaton të njëjtin standard të vlerësimit të besueshmërisë së dëshmitarëve; prandaj Trupi gjykues nuk sheh ndonjë gabim me deklarinin e pjesës së deklaratës së palës së dëmtuar I.P., M.P., D.S. dhe I.S. në lidhje me Akuzën 11 si pjesërisht të besueshme.

98. Megjithatë, Trupi gjykues dëshiron të theksojë se edhe pse deklaratat ishte shpallur si të pranueshme dhe të besueshme, Gjykata Themelore ka konstatuar se elementet e krimin përkitazi me Akuzën 11 nuk janë plotësuar. Gjykata Themelore ka marrë parasysh kryesisht

se asnjëri nga 4 (katër) palët e dëmtuara nuk ishte në pozitë për të njohur ndonjërin nga policët në automjetin me tabela 288-01 (shih faqet 41, 47 dhe 52 të Aktgjykimit PRK 1098/13 të Gjykatës Themelore në Prishtinë). Mungesa e identifikimit të kryesit është një çështje kryesore madhore në vendosjen e dyshimit të arsyeshëm në fajësinë e të pandehurve. Prandaj, Trupi gjykues konsideron se Prokuroria nuk ka treguar se Gjykata Themelore ka gabuar në vlerësimin e vet të provave për sa i takon Akuzës 11.

99. Ngjashëm, Trupi gjykues konsideron se Gjykata Themelore saktë ka vlerësuar deklaratën e palës së dëmtuar M.J. në lidhje me identifikimin e katër policëve që ishin në automjet. Gjykata Themelore ka konstatuar se kjo pjesë e deklaratës së M.J. ka shumë kundërthënie dhe nuk ka mundësi të konstatohet përtej dyshimit të arsyeshëm se I.R., J.R., V.K. dhe Z.S. e kishin goditur atë në automjet (shih faqen 103 të Aktgjykimit PKR 1098/13 të Gjykatës Themelore në Prishtinë).

100. Trupi gjykues vëren se në procedurat penale, identifikimi i të pandehurit si kryes i krimit është një element që duhet të dëshmohet nga ana e Prokurorisë përtej dyshimit të arsyeshëm. Në rastin aktual, pala e dëmtuar nuk e ka identifikuar I.R., V.K. dhe Z.S. fare. M.J. u identifikoi J.R. në fazën paraprake në pajtim me Nenin 120 të KPP; megjithatë, ai ndryshoi dëshminë e tij gjatë gjykimit kryesor. Gjykata Themelore gjithashtu ka marrë parasysh se është dëshmuar se katër të pandehurit kanë qenë në automjet dhe se V.K. ka qenë vozitësi; megjithatë, pala e dëmtuar nuk ishte në gjendje ti identifikojë policët gjatë gjykimit kryesor. Trupi gjykues e ka parasysh se mendja njerëzore nuk punon si video regjistruar. Një person nuk mundet thjeshtë ta ri përsërit një regjistrim mendor për t`a kujtuar atë që ka ndodhur. Memoria dhe perceptimi janë shumë më tepër të komplikuar. Prandaj, kundërthënia në një çështje aq të madhe si identifikimi i personit i cili ka goditur palën e dëmtuar do të adresohet më shumë kujdes.

101. Në bazë të Nenit 3(2) të KPP, dyshimet në lidhje me ekzistimin e fakteve relevante për rastin do të interpretohen në favor të pandehurit. Prandaj, Trupi gjykues konsideron se Gjykata Themelore në mënyrë të drejtë ka zbatuar parimin in dubio pro reo dhe e ka shpallur

të pafajshëm I.R., J.R., V.K. dhe Z.S. për veprën penale siç përshkruhet në detaje në Akuzën 12.

h. Shkelja e zbatimit të konceptit të bashkë-kryerjes

102. Prokuroria pretendon se Gjykata Themelore ka zbatuar drejtë nocionin e bashkëkryerjes siç ceket në Nenin 31 të KPP dhe në Aktakuzë.

103. Prokuroria pretendon se të pandehurit të cilët nuk ishin të njohur me emër nga palët e dëmtuara janë po ashtu përgjegjës për veprat penale. Së pari, të gjithë ata kanë pasur role aktive në veprat penale. Është vërtetuar gjatë gjykimit kryesor se të gjithë ata ose i kanë shoqëruar të burgosurit nga qendrat e paraburgimit ose kanë qenë pjesë e të ashtu quajturit “korridor” dhe kanë qenë në fugon ku janë abuzuar të burgosurit. Së dyti, Prokurori pretendon se ekzistojnë prova të mjaftueshme për ti dëshmuar elementet e cekur në Nenin 31 të KPK: (1) të pandehurit kanë kryer krimet e përshkruara në Akuzat 1, 2, 3, 11 dhe 12 vullnetarisht ose duke i abuzuar ose keqtrajtuar palët ose duke kontribuar në mënyrë thelbësore në abuzim ose keqtrajtim; (2) të gjithë të pandehurit kanë kryer në bashkëkryerje edhe pa pasur ndonjë rregullim të caktuar të roleve dhe veprimeve të tyre; (3) të pandehurit si policë kanë qenë në dijeni për mundësinë se krimi do të ndodh edhe si pasojë e mosveprimeve të tyre. Të gjithë të pandehurit duke qenë përfaqësues të shtetit kanë pasur obligim pozitiv për ti mbrojtur viktimat që ishin të burgosur atëbotë nga çdo lloj sulmi apo keqtrajtimi. Një obligim i tillë rrjedh nga Ligji mbi Policinë, Kushtetutën e Kosovës dhe KEDNj.

104. Prokuroria nuk pajtohet me konstatimet e Gjykatës Themelore se veprimet e të pandehurve nuk ishin të mjaftueshme aq sa të tregojnë për qëllimin indirekt dhe se aktakuza përmban akuza për kryerjen e veprave penale me veprim e jo me mos veprim. Prokurori thekson se Neni 31 i KPK qartë tregon se bashkëkryerja ekziston kur dy apo më shumë persona bashkërisht kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në veprën penale ose duke kontribuar në mënyrë thelbësore në kryerjen e saj në çdo mënyrë tjetër. Më tej, në pajtim me

Nenin 8(1) të KPK, vepra penale mund të kryhet me veprim ose mos veprim. Në këtë drejtim, Prokuroria prezanton një analizë të detajuar të jurisprudencës së Gjykatës Supreme dhe gjykatave ndërkombëtare në mbështetje të pretendimit të saj.

105. Së fundi, Prokuroria nuk pajtohet me konstatimin e Gjykatës Themelore se Aktakuza nuk parasheh kryerjen e veprave penale me mos kryerje. Por, Prokuroria thotë se Aktakuza i plotëson kriteret e Nenit 241 (1.4) të KPP. Kryerja e veprës penale me mos kryerje duhet lexuar si pjesë e definicionit të bashkëkryerjes siç përcaktohet në Nenin 31 të KPK.

106. Gjykata Themelore e ka adresuar çështjen e bashkëkryerjes në detaj në dritën e vlerësimit të gjendjes faktike. Gjykata Themelore ka konstatuar se policët që nuk ishin identifikuar nga palët e dëmtuara nuk mund të mbahen përgjegjës për pjesëmarrje direkte në bashkë-kryerje. Gjykata Themelore pajtohet me fjalën përmbyllëse të Prokurorit në pjesën ku duke qenë se prania e të gjithë të pandehurve ishte vërtetuar në vendin e krimit, ata mund të mbahen përgjegjës për veprën penale të kryer me mos kryerje. Megjithatë, pasi që të pandehurit nuk ishin akuzuar për veprat penale të kryera me mos kryerje në aktakuzë (shih faqet 108-110 të Aktgjykimit PKR 1098/13 të Gjykatës Themelore në Prishtinë).

107. Neni 31 i KPK, e definon bashkë-kryerjen me sa vijon: “Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepër penale.” Elementet e bashkëkryerjes sipas këtij neni janë: disa persona, pjesëmarrja në kryerje apo dhënia e një kontributi vendimtar i cili është i rëndësishëm dhe pa të cilin vepra penale nuk do të mund të kryhej apo nuk do kryhej në mënyrë të planifikuar dhe vullneti për të kryer një vepër penale si e tij (qëllimi i përbashkët). Bashkëkryerja është një formë e kryerjes ku disa persona, ku secili përmbush elementet e kërkuar për një kryer, me vetëdije dhe kryen një vepër penale. Në kundërshtim me një ndihmës apo iniciator, bashkëkryesit nuk marrim pjesë në një vepër të kryer nga një person tjetër. Bashkëkryesi merr pjesë në veprën e tij, kurse ndihmësit dhe iniciatorët marrin pjesë në veprën e dikujt tjetër.

108. Në rastin aktual, është vërtetuar se të gjithë të pandehurit kanë qenë të pranishëm në vendin e krimit. Sidoqoftë, në lidhje me Akuzat 1, 2 dhe 3, palët e dëmtuara nuk ishin në gjendje të identifikonin numrin e saktë të të pandehurve që ishin pjesë e “korridorit”, ose identitetet e atyre të pandehurve (shih paragrafët 86-93 të aktgjykimit aktual). Në lidhje me Akuzat 11 dhe 12, është vërtetuar se cilët të pandehur kanë qenë të pranishëm në dy automjete: sidoqoftë, palët e dëmtuara nuk ishin në gjendje të identifikonin të pandehurit apo t’ia veshin një veprim të caktuar një të pandehuri të caktuar (shih paragrafin 94-101 të aktgjykimit aktual).
109. Në këtë drejtim, Trupi gjykues vëren se me qëllim që të pandehurit të mbahen përgjegjës për bashkëkryerje, është e domosdoshme të tregohet kontributi i secilit të pandehur ndaj një akti të caktuar pa kontributin e të cilit nuk do kryhej vepra penale. Më tej është vendimtare të dëshmohet se një i pandehur i caktuar e ka ndarë qëllimin me të pandehurit tjerë për kryerjen e veprës penale të tij. Trupi gjykues ndan mendimin e Gjykatës Themelore se vetëm prania në vendin e krimit nuk mjafton për të përcaktuar kontributin e secilit të pandehur në kauzën e përbashkët të veprës penale apo të tregojë se kanë pasur për synim të kryejnë të njëjtën veprë penale. Vetëm prania nuk mund të dëshmojë në mënyrë të mjaftueshme pjesëmarrjen ose qëllimin; prandaj, trupi gjykues konsideron se elementet e bashkëkryerjes së drejtpërdrejte nuk janë përmbushur.
110. Vepra penale mund të kryhet me veprim ose mos veprim. Mos veprimi është dështimi për të kryer një veprim, e që përgjithësisht tërheq pasoja të ndryshme ligjore nga sjellja pozitive. Në të drejtën penale, një mos veprim përbën një actus reus dhe përbën përgjegjësi vetëm kur ligji obligon veprimin kurse i pandehuri shkel atë detyrim. Përgjegjësia për mos veprim presupozon një detyrim për të vepruar nga ana e një personi me pozitë të caktuar (specifike).
111. Në rastin aktual, të gjithë të pandehurit janë policë të cilët ishin caktuar zyrtarisht të shoqërojnë të burgosurit nga Qendra e Paraburgimit për në Gjykatën për Kundërvajtje (shih faqen 97 të Aktgjykimit PKR 1098/13 të Gjykatës Themelore në Prishtinë). Sipas Nenit 10 (1) të Ligjit Nr. 04/L-076 mbi Policinë, “Policia do të ketë këto detyra të përgjithshme: 1.1.

mbrojtjen e jetës, pronës dhe të ofrojnë siguri për të gjithë njerëzit; 1.2. të mbrojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të gjithë qytetarëve”. Më tej, në pajtim me nenin 13 (3) të Ligjit nr 04/L-076 mbi Policinë, “Një polic nuk do të nxis, fillojë, mbështet ose tolerojë asnjë akt të torturës apo jo-njerëzor apo trajtim degradues në asnjë rrethanë, dhe asnjë urdhër i lëshuar nuk mund të arsyetojë një veprim të tillë”. Prandaj, të gjithë të pandehurit kanë qenë në detyrë zyrtare gjatë ngjarjeve të pretenduara dhe e kanë pasur për detyrë të veprojnë në rsat të trajtimit jo njerëzor dhe degradues. Nuk ka mbështetje në dosjen e lëndës që tregon se të pandehurit kanë ndërmarrë ndonjë veprim për të parandaluar keqtrajtimin e palëve të dëmtuara. Megjithatë, Trupi gjykues vëren se kryerja e veprës penale me mos kryerje nuk ishte diskutuar apo ngritur gjatë gjykimit kryesor. Po ashtu, Aktakuza gjatë përshkrimit të Akuzat 1, 2, 3, 11 dhe 12 ka përmendur vetëm pjesëmarrjen aktive në veprat penale nga ana e të pandehurve.

112. Në pajtim me nenet 10 dhe 241 (1)(1.4) të KPP, i pandehuri duhet të informohet në mënyrë të qartë lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet. Ky është një obligim absolut i Prokurorit dhe nuk mund të bartet mbi Trupin gjykues apo mbrojtjen. Derisa Trupi gjykues në parim pajtohet se neni 31 i KPK është mjaftueshëm i gjerë për të përfshirë bashkë-kryerjen me veprin a mos veprim, Aktakuza në rastin aktual qartazi dhe në mënyrë ekskluzive përshkruan vetëm pjesëmarrjen aktive në veprat penale. Prandaj, të gjitha dyshimet përkitazi me vërtetimin e fakteve ose zbatimin e dispozitave ligjore duhet të trajtohen në dritën e parimit in dubio pro reo. Për këtë arsye, Trupi gjykues pajtohet me Gjykatën Themelore se të pandehurit nuk mund të shpallen fajtorë për kryerjen e veprave panel në bashkë-kryerje me mos veprim pasi që ata nuk janë akuzuar për një lloj të tillë vepre. Rrjedhimisht, pretendimet e Prokurorisë në lidhje me zbatimin e elementeve të konceptit të bashkëkryerjes refuzohen si të pabazuara.

i. Vepra penale e Sulmit e cilësuar gabimisht, siç përshkruhet në nenin 187(1) dhe (2) të KPK

113. Mbrojtja e G.K., S.S., N.D. dhe I.R. pretendon se aktgjykimi i Gjykatës Themelore përmban shkelje të të drejtës penale. Gjykata Themelore gabimisht e ka dënuar një të

pandehur për më shumë se një vepër penale si rezultat i veprës së njejtë. I pandehuri është dashur të dënohet vetëm për Keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare apo autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198(1) të KPK pasi që kjo vepër penale përfshin veprat e tjera penale. Mbrojtja pretendon se vepra penale e Sulmit përfshihet nga vepra penale e Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare për shkak të këtyre aspekteve: (1) vepra penale e Sulmit nuk e ka elementin se ndikimit fizik të palës së dëmtuar për derisa edhe ndikimi më i vogël fizik konsiderohet si një element i veprës penale Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare; (2) vepra penale e Sulmit mund të kryhet nga çdo kush kurse vepra penale Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare mund të kryhet vetëm nga personat në cilësinë e tyre zyrtare; (3) vepra penale e Sulmit ka një definicion të gjerë me elemente më të shumta se vepra penale Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare.

114. Mbrojtja pretendon se i pandehuri N.D. ishte shpallur fajtor për veprën penale Sulm siç përcaktohet me nenin 187(2) të KPK (Akuza 18) për goditjen e të burgosurit D.V. me çizme ushtarake. Mbrojtja pretendon se Gjykata Themelore gabimisht e ka cilësuar veprën penale të Sulmit sipas përcaktimit nga neni 187(2) të KPK. Vepra penale e Sulmit kërkon që akti të kryhet ose me “objekt të rrezikshëm” ose “një objekt tjetër që ka mundësi të shkaktojë lëndim të rëndë trupor apo dëmtim serioz të shëndetit”. Në rastin aktual, Gjykata Themelore nuk e ka qartësuar nëse çizmet ushtarake konsiderohen si objekt i rrezikshëm apo një objekt tjetër. Edhe nëse çizmet ushtarake do të konsideroheshin si një objekt tjetër, Gjykata Themelore nuk ka arritur të tregojë se janë shkaktuar pasojat e lëndimit të rëndë trupor ose një dëmtim serioz i shëndetit.

115. Në fillim, Trupi gjykues vëren se pas dëgjimit fillestar dhe të dytë, të pandehurit kanë paraqitur kundërshtimet ndaj Aktakuzës PP: II 111/2013 të ngritur më 12 dhjetor 2013 në bazë të neneve 249 dhe 250 të KPK. Kryetari i trupi gjykues ka lëshuar një Vendim përkitazi me kundërshtimet me datë 14 prill 2014, duke i refuzuar si të pabazuara si dhe duke i refuzuar kundërshtimet në lidhje me pranueshmërinë e provave në dosjen e lëndës. Palët e kanë përdorur të drejtën e tyre të ankesës ashtu si ceket në nenin 250(4) të KPK. Më 3 qershor 2014, Gjykata e Apelit e ka lëshuar një Vendin PN 262/14 me të cilin Aktakuza e

datës 12 dhjetor 2013 ishte plotësuar për sa i takon cilësimin ligjor të akuzave ashtu si është përmendur në detaje në dispozitivin e Vendimit PN 262/14 (shih faqet 7-9 të Vendimit PN 262/14 datë 3 qershor 2014).

116. Në lidhje me nenin 187(1) të KPK, Gjykata e Apelit ka konstatuar me sa vijon: *“Pas përjashtimit të zbatimit të neneve 187(2) dhe 187(3) të KPRK, Trupi gjykues tani duhet ta vërtetojë raportin ndërmjet veprës penale të Keqtrajtit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimit publik në nenin 198 (1) KPRK dhe veprës penale të Sulmit (forma themelore) në nenin 187(1) të KPRK. Trupi gjykues gjen se një cilësim më specifik në dritën e fakteve të supozuara është vepra penale e Keqtrajtit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimit publik në bazë të nenin 198(1) të KPRK. Të pandehurit pretendohet se kanë keqpërdorur pozitat e tyre dhe autorizimet si policë të cilëve u ishte besuar transportimi i të burgosurve dhe përmes veprimeve të tyre ata kanë fyer dinjitetin e tyre dhe/ose i kanë keqtrajtuar ata. Koncepti ligjor i keqtrajtit të dikujt me përdorimin e forcës dhe shkaktimi i lëndimit trupor nga një person zyrtar veç e dënon zbatimin e forcës së një vepre penale tipit të sulmit. Trupi gjykues prandaj konstaton se, në vlerë nominale, vepra penale e pretenduar përbën veprën penale sipas nenit 198(1) të KPRK. Më tej, në lidhje me nenin 187(2) të KPK, Gjykata e Apelit ka konstatuar me sa vijon: “Më tej, as elementet e veprës penale nga neni 187(2) të KPRK nuk janë plotësuar. Dispozita kërkon që sulmi të kryhet me një armë, një instrument të rrezikshëm apo një objekt tjetër i cili mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor ose dëmtim serioz të shëndetit. Prokurori në aktakuzë nuk i referohet përdorimit të ndonjë armë apo instrumenti të tillë në keqtrajtimin e pretenduar”.*

117. Më 8 korrik 2014, Prokuroria Themelore e EULEX-it ka lëshuar plotësimin e akuzave të pandehurve pas plotësimeve të bëra nga Gjykata e Apelit me Vendimin e saj të datës 3 qershor 2014. Akuzat e plotësuara i janë dorëzuar të pandehurve më 11 korrik 2014.

118. Trupi gjykues e ka parasysh se Gjykata e Apelit në vendimin e saj të datës 3 korrik 2014 e ka pranuar se ri-cilësimi i akuzave ishte kryer vetëm në bazë të Aktakuzës, dhe Trupi gjykues e ka ende fuqinë që përfundimisht të përcaktojë cilësimin përkatës ligjor në mënyrë

përfundimtare. Megjithatë, nuk ka asgjë në dosjen e lëndës që do të tregonte se Gjykata e Qarkut i ka shqyrtuar akuzat e plotësuara dhe ka lëshuar një mendim të arsyetuar se pse plotësimet e tilla duhet të kthehen në Aktakuzën fillestare. Më tej, çështja e aktakuzës së plotësuar nuk është adresuar në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore.

119. Trupi gjykues vëren edhe pse pa ndonjë referencë ndaj akuzave të plotësuara, Gjykata Themelore ka shprehur mos pajtimin se vepra penale e Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare apo autorizimeve publike në kundërshtim me nenin 198(1) të KPK përfshin veprën penale të Sulmit në kundërshtim me nenin 187(1) dhe (2) të KPK. Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit dallojnë në mendimet e tyre se dy veprat penale mbrojnë të njëjtën vlerë ligjore. Për këtë arsye, Gjykata Themelore ka konstatuar se dy veprat penale bashkë-ekzistojnë dhe mund të kryhen në mënyrë të njëkohshme me një veprim (shih faqen 107 të Aktgjykimit PKR 1098/13 të Gjykatës Themelore në Prishtinë). Derisa Gjykata e Apelit ka gjetur se ligjvënësi ka pasur për synim mbrojtjen e të njëjtës vlerë sepse koncepti ligjor i keqtrajtimit të dikujt me përdorimin e forcës dhe shkaktimin e lëndimit trupor nga një person zyrtar veç e ndëshkon përdorimin e forcës së një vepre penale tipike të sulmit.

120. Subsuming është një term i cili përdoret për regjistrimin e një numri veprash penale si një krim. Me qëllim të përcaktimit nëse një vepër penale është përfshirë nga një tjetër, është e domosdoshme të shqyrtohen me kujdes elementët e secilës vepër penale. Konsumimi i referohet një raportit ndërmjet veprave të të njëjtit lloj, por të serioziteti (rëndësia) të ndryshme, që janë të përcaktuara të mbrojnë të njëjtin apo një interes shoqëror përafërsisht të ndërlidhur, por që dallojnë në lidhje me elemente të caktuara. Sidoqoftë, një parim i vendosur thekson se dënimi nuk duhet shpallur (urdhëruar) si për veprën më të rëndë apo më specifike ashtu edhe për veprën më të lehtë. Në vend të kësaj, vepra më e rëndë penale e tërheq (përfshin) atë më të dobëtën (*lex consumens derogat legi consumtae*). Shpjegimi këtu është se vepra më e madhe dhe më e vogël përbëjnë të njëjtën vepër themelore, pa ndonjë dallim të theksuar mes tyre, edhe kur veprimi i njëjtë shkel dy dispozita të dallueshme statutore. Në të vërtetë, nuk është e mundur të kryhet vepra më e rëndë pa kryer po ashtu edhe veprën më të

lehtë. Prandaj, nuk mjafton të tregohet se veprat penale janë vendosur në kapituj të ndryshëm brenda KPK.

121. Në rastin aktual, Trupi gjykues vëren se nuk ekziston një hierarki strike ndërmjet veprave penale të Sulmit siç përcaktohet me nenin 187(1) të KPK dhe Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare apo autorizimeve publike siç përcaktohet me nenin 198 (1) të KPK. Sidoqoftë, Trupi gjykues vëren se dy veprat penale ndajnë veprën e njëjtë në themel, e që është – keqtrajtimi i dikujt dhe zbatimi i forcës kundër dikujt është e të njëjtës natyrë dhe drejtohet ndaj një personi. Megjithatë, vepra penale e Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimit publik siç përcaktohet me nenin 198(1) të KPK kërkon një element shtesë – keqtrajtimit duhet të kryhet nga një person zyrtar gjatë keqpërdorimit të pozitës apo autorizimit zyrtar të tij/saj. Prandaj, vepra penale e Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare apo autorizimit publik siç përcaktohet me nenin 198(1) të KPK është një vepër penale më specifike që kërkon dëshmi edhe të një elementi shtesë. Në rast se ky element shtesë nuk dëshmohet, veprimet e kryesit do të konsideroheshin si vepër penale e Sulmit siç përcaktohet me nenin 187(1) të KPK.
122. Për këtë arsye, Trupi gjykues ndan mendimin me Gjykatën e Apelit dhe konsideron se vepra penale e sulmit siç përcaktohet me nenin 187(1) të KPK përfshihet brenda veprës penale të Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare apo autorizimeve publike, siç përcaktohet me nenin 198 (1) të KPK. Prandaj, ankesat e avokatit mbrojtës G.K., S.S., N.D. dhe I.R. në këtë pjesë aprovohen.
123. Në lidhje me veprën penale të Sulmit, siç është përcaktuar në nenin 187 (2) të KPK-së, Gjykata Themelore i referohet përkufizimit të objektit të rrezikshëm të përcaktuar në nenin 120 (32) të KPK-së dhe konkludon se çizmet ushtarake të veshura nga njerëz të trajnuar mund të konsiderohen si instrumente të rrezikshme të cilat mund të shkaktojnë lëndime të rënda trupore. Më tej, arsyetimi i Aktgjykimit të Gjykatës Themelore është jo i plotë dhe nuk është e qartë se si vepra penale e Sulmit siç është përshkruar në nenin 187 (2) të KPK-së ishte e kualifikuar në lidhje me të pandehurin G.K. (shih faqen 107 të Aktgjykimit PKR 1098/13 të Gjykatës Themelore të Prishtinës).

124. Trupi gjykues thekson që Gjykata Themelore përsëri nuk i referohej akuzave të modifikuara dhe nuk shpjegoi pse rrjedh nga këto akuza. Gjykata Themelore shpjegoi më tej vetëm përdorimin e çizmeve ushtarake si instrument të rrezikshëm. Arsyetimi i aktgjykimit në lidhje me përdorimin e objektit tjetër është jo i plotë dhe i papërfunduar. Trupi gjykues konsideron se Gjykata Themelore nuk ofroi arsyetime të mjaftueshme që tregojnë se çizmet ushtarake apo ndonjë objekt tjetër mund të konsiderohen si një instrument i rrezikshëm dhe ndan mendimin e Gjykatës së Apelit të shprehur në Aktvendimin PN 262/14 të datës 3 qershor 2014 që Prokuroria nuk i referohet ndonjë arme ose objekti të rrezikshëm në Aktakuzë. Prandaj, kushtet e nenit 187 (2) të KPK-së nuk plotësohen sepse nuk është vërtetuar se sulmi është kryer me armë, një instrument të rrezikshëm ose një objekt tjetër që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor ose dëmtim serioz për shëndetin. Prandaj, ankesa e mbrojtësit të N.D. aprovohet në këtë pjesë.

125. **Prandaj, të pandehurit G.K., S.S., N.D., N.Z. dhe I.R. janë shfajësuar nga veprat penale të Sulmit, në kundërshtim me nenin 187 (1) të KPK, siç përshkruhet në dispozitivin e këtij aktgjykimi.**

126. **G.K. më tej shfajësohet nga vepra penale e Sulmit, në kundërshtim me nenin 187 (2) të KPK në lidhje me nenin 31 të KPK-së (Akuza 3), Sulm, në kundërshtim me nenin 187 (2) të KPK-së në (Akuza 18) dhe Sulm, në kundërshtim me nenin 187 (2) të KPK (Akuza 9), i pandehuri S.S. shfajësohet nga vepra penale e Sulmit, në kundërshtim me nenin 187 (2) të KPK (Akuza 3), dhe i pandehuri N.D. shfajësohet nga vepra penale e Sulmit, në kundërshtim me nenin 187 (2) të KPK në lidhje me nenin 31 të KPK-së (Akuza 18) siç përshkruhet në dispozitivin e këtij aktgjykimi.**

i. Vepra e rëndësisë së vogël

127. Mbrojtja e N.D. pretendon se në kundërshtim me dispozitivin e aktgjykimit të kundërshtuar, në arsyetim Gjykata Themelore vuri në dukje se B.M. e identifikoi N.D. si një person që u përpoq ta godiste të paraburgosurin në ndërtesën e komunës. Mbrojtja e N.D. shton se nuk ka prova në dosjen e lëndës që N.D. e goditi B.M.. I dëmtuari vetë e identifikoi

N.D. si zyrtar policor që u përpoq ta godiste atë. Më tej, deklarata se B.M. u godit në sallën e gjyqit të Gjykatës për Kundërvajtje nuk mbështetet nga ndonjë dëshmi tjetër apo deklaratë dëshmitare dhe është në kundërshtim me deklaratat e tij të tjera në të cilat ai nuk e ka identifikuar fare N.D..

128. Prandaj, përpjekja për të goditur duhet të kualifikohet si një veprë e rëndësisë së vogël siç përshkruhet në nenin 11 të KPK-së. Gjatë ngjarjeve relevante, i pandehuri N.D. veprroi si pjesë e NJSO-së. Kjo njësi është e detyruar të ndjekë kërkesat ligjore të përcaktuara në Ligjin Nr. 04 / L-076 për Policinë. Në pajtim me këtë ligj, anëtarët e policisë përfshirë dhe NJSO nuk duhet të mbahen penalisht përgjegjës për veprimet me rëndësi të vogla. Këto vepra bien nën veprat disiplinore siç përshkruhet në nenet 11 dhe 12 të Ligjit për Policinë.

129. Gjykata Themelore vërtet e dinte se i pandehuri N.D. u përpoq të godiste B.M. në sallën e gjyqit. Sidoqoftë, në arsyetimin e dhënë në faqen 95 të Aktgjykimit PKR 1098/13 të Gjykatës Themelore të Prishtinës, Gjykata Themelore shpjegon se më tej është vërtetuar se kur B.M. ishte ulur në karrige, ai mori një numër goditjesh. Ky veprim mbulohet nga Akuza 5. Bazuar në këtë deklaratë, deklarata e të dëmtuarit D.V. dhe raportit të policisë, Gjykata Themelore konkludon se i pandehuri N.D. është përgjegjës për goditjen e B.M. (*shih* faqet 95-96 të Aktgjykimit PKR 1098/13 të Gjykatës Themelore të Prishtinës, faqet 20 dhe 45 të Procesverbalit kryesor të gjykimit të 19 nëntorit 2014). Prandaj, Trupi Gjykues pajtohet plotësisht me këtë arsyetim dhe konsideron se mbrojtja nuk ka treguar ndonjë gabim në përcaktimin e gjendjes faktike në këtë drejtim.

130. Gjykata Themelore tregon se veprat e kryera nga i pandehuri janë në kundërshtim me detyrat e tij zyrtare dhe detyrimet e përcaktuara në nenin 12 dhe 13 të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë, i cili nuk mund të konsiderohet si një veprë e rëndësisë së vogël siç është përcaktuar në nenin 11 të KPK-së (*shih* faqen 99 të Aktgjykimit PKR 1098/13 të Gjykatës Themelore të Prishtinës).

131. Trupi gjykues thekson që në vlerësimin e veprës me rëndësi të vogël, është e nevojshme të merren parasysh rrethanat e përgjithshme të rastit. Neni 11 i KPK-së thekson se veprimet

konsiderohen të jenë të një rëndësie të vogël kur rreziku i përfshirë është i parëndësishëm për shkak të natyrës dhe seriozitetit të veprës; mungesa ose pakësimi i pasojave të synuara; rrethanat në të cilat është kryer vepra; shkalla e ulët e përgjegjësisë penale të kryerësit; ose rrethanat personale të kryerësit. Në rastin aktual janë 11 (njëmbëdhjetë) të pandehur dhe 10 (dhjetë) palë të dëmtuara. Të pandehurit ishin në detyrë zyrtare gjatë kryerjes së veprës penale. Vepra penale u krye në ambientet e Qendrës së Paraburgimit, automjeteve zyrtare të policisë dhe Gjykatës për Kundërvajtje. Prandaj, Trupi gjykues ndan mendimin e Gjykatës Themelore se për shkak të numrit të madh të të pandehurve dhe palëve të dëmtuara, natyra serioze e veprës penale dhe fakti që të pandehurit ishin në detyrë zyrtare është e mjaftueshme për të konstatuar se veprat e të pandehurve nuk mund të konsiderohen si vepra me rëndësi të vogël. Prandaj, kushtet e nenit 11 të KPK-së nuk janë plotësuar. Për këtë arsye, pretendimet e mbrojtësit të N.D. refuzohen si të pabazuara.

k. Mos vlerësimi i motivit

132. Mbrojtja e S.S. dhe I.R. pretendon se Gjykata Themelore nuk ka arritur të vlerësojë motivin e veprave penale.
133. Në kundërshtim me deklaratën e mbrojtjes, aktgjykimi i Gjykatës Themelore vërtetoi se dyshohet që keqtrajtimi ishte bazuar në motive etnike (*shih* faqen 101 të Aktgjykimit PKR 1098/13 të Gjykatës Themelore të Prishtinës). Megjithatë, trupi gjykues dëshiron të theksojë se aktgjykimi i Gjykatës Themelore nuk është plotësisht i qartë në konkluzionet e tij se të pandehurit kanë kryer keqtrajtimin e supozuar bazuar në motivet etnike.
134. Trupi Gjykues përkujton që elementet e veprave penale të Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike siç është përcaktuar në nenin 198 (1) të KPK-së dhe Kanosjes, në kundërshtim me nenin 185 (4) lidhur me paragrafin 1 të KPK-së nuk përfshin domosdoshmërinë për të përcaktuar motivin e të pandehurve. Në këtë drejtim, nocioni i motivit nuk duhet të trajtohet në mënyrë të barabartë me nocionin e qëllimit. Qëllimi nënkupton objektiv ose qëllim të ndërgjegjshëm. Kështu, një person kryen një vepër penale me qëllim kur objektivi ose qëllimi i vetëdijshëm i këtij personi është të angazhohet në

veprën që ligji e ndalon ose të sjellë një rezultat të paligjshëm. Motivi, nga ana tjetër, është arsyeja pse personi zgjedh të angazhohet në sjellje kriminale. Në rastet kur qëllimi është element i një krimi të ngarkuar, ky element duhet të vërtetohet përtej një dyshimi të arsyeshëm. Motivi, megjithatë, nuk është një element i krimeve të ngarkuara. Prandaj, nuk ka asnjë kriter për të provuar një motiv për kryerjen e krimit të ngarkuar (s). Në rast se ka dëshmi të një motivi, ajo duhet të konsiderohet, për shembull, në përcaktimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese.

135. Në rastin në fjalë, Gjykata Themelore refuzoi provat lidhur me motivin e pretenduar. Prandaj, Trupi Gjykses konsideron se nuk ka shkelje në emër të Gjykatës Themelore për mos marrje parasysh të motivit të mundshëm. Rrjedhimisht, pretendimet e avokatit mbrojtës të S.S. dhe I.R. refuzohen si të pabazuara.

l. Tejkalimi i akuzave

136. I pandehuri I.R. pretendon se Gjykata Themelore e tejkaloj fushëveprimin e akuzës duke shpallur dënimin plotësues. Aktgjykimi është në shkelje të nenit 384 (1) (1.10) të KPP-së, sepse Gjykata Themelore e tejkalon fushëveprimin e akuzës duke caktuar dënimin plotësues. Ky dënim nuk ishte kërkuar në aktakuzë.

137. Trupi gjykses thekson se në pajtim me nenin 62 (1) të KPK-së, mund të shqiptohet një dënim plotësues së bashku me një dënim kryesor ose alternativ. Formulimi i këtij neni, në veçanti përdorimi i fjalës "mund", tregon se Gjykata Themelore ka diskrecion për të vendosur nëse rrethanat e veçanta të rastit kërkojnë vendosjen e dënimit plotësues. Prandaj, trupi gjykses konsideron se nuk kishte nevojë që ky lloj dënimi të përfshihej në aktakuzë. Pretendimet e të pandehurit I.R. refuzohen si të pabazuara.

m. Llogaritja e gabuar e dënimit unik

138. I pandehuri I.R. pretendon se Gjykata Themelore ka shkelur nenin 384 (1) (1.12) të KPP-së në lidhje me nenet 370 (5) të KPP-së dhe 80 (2) (2.2) të KPK-së. Në pajtim me nenin 80 (2) (2.2) të KPK-së, dënimi i përgjithshëm i shqiptuar nuk mund të jetë po aq i lartë sa të gjitha dënimet e përshkruara. Në rastin e I.R., Gjykata Themelore shqiptoi gjashtë (gjashtë) muaj burg për secilën veprë penale; ndërsa dënimi i përgjithshëm është 1 (një) vit.
139. I pandehuri I.R. u dënua me 6 (gjashtë) muaj burgim, ekzekutimi i të cilit pezullohet sipas nenit 51 (2) të KPK-së për periudhën e verifikimit për 1 (një) vit për veprën penale të Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198 (1) të KPK-së dhe 6 (gjashtë) muaj burgim, ekzekutimi i të cilit pezullohet sipas nenit 51 (2) të KPK-së për periudhën e verifikimit për 1 (një) vit për veprën penale të Sulmit, në kundërshtim me nenin 187 (1) të KPK-së. Ai u dënua me dënim të përgjithshëm prej 1 (një) vjet burgim, ekzekutimi i të cilit pezullohet në bazë të nenit 51 (2) të KPK-së për periudhën e verifikimit prej 2 (dy) vitesh.
140. Trupi gjykues thekson se në pajtim me nenin 80(2) (2.2) të KPK-së, dënimi i përgjithshëm me burgim duhet të jetë më i lartë se çdo dënim individual, por dënimi i përgjithshëm nuk mund të jetë po aq i lartë sa shuma e të gjitha dënimeve të përshkruara. Ky nen rregullon në mënyrë të qartë llogaritjen e dënimit të veprave penale në harmoni dhe nuk e lë atë në diskrecionin e Trupit Gjykues për të vendosur një dënim që është i barabartë me shumën e të gjitha dënimeve të përshkruara. Prandaj, trupi gjykues konsideron se llogaritja e dënimit të përgjithshëm në lidhje me të pandehurin I.R. është bërë në kundërshtim me dispozitat e nenit 80 (2) (2.2) të KPK-së.
141. Ndryshimi i dënimit të shqiptuar ndaj të pandehurit I.R. do të trajtohet në kapitullin vijues

n. Përcaktimi i sanksioneve penale

142. Mbrojtja e G.K., S.A., N.D., dhe i të pandehurit I.R. pohon se si rrjedhojë e shkeljeve të procedurës penale dhe të së drejtës penale si dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, Gjykata Themelore gabimisht e zbatoi dënimin penal për të pandehurin. Mbrojtja e S.S. shton se me dënimin shtesë të ndalimit të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik për 3 (tre) vjet është i panevojshëm pasi rezulton me shkelje të ligjit penal dhe qëllimi i dënimit mund të arrihet lehtë pa dënimin shtesë.
143. Trupi gjykues konsideron se Gjykata Themelore, përveç shkeljes së nenit 80 (2) (2.2) të KPK-së të detajuar në paragrafët 138-141 të këtij aktgjykimi, ka përcaktuar me korrektësi sanksionet penale për të gjithë të pandehurit. Gjykata Themelore ndoqi kriteret e ligjit dhe aplikoi në mënyrë korrekte parimet për zbatimin e sanksionit penal. Gjykata Themelore ka konsideruar në mënyrë të duhur të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese.
144. Trupi gjykues më tutje merr parasysh modifikimin e Aktgjykimit PKR 1098/13 të Gjykatës Themelore të Prishtinës në lidhje me shfaqësimet e diskutuara në paragrafët 113-126 të këtij aktgjykimi dhe shkeljet e nenit 80 (2) (2.2) të KPK-së të detajuar në paragrafët 138-141, dhe konsideron se sanksioni penal i shqiptuar nga Gjykata Themelore do të modifikohet.
145. Në lidhje me përcaktimin e sanksionit penal, Trupi Gjykues përkujton parimet kryesore të përcaktuara në nenet 41, 73, 74 dhe 80 të KPK-së. Një sanksion penal do të konsiderohet si një mjet i fundit që synon të mbrojë vlerat shoqërore dhe nuk mund të ndërhyjë përtej asaj që është gjetur si tepër e nevojshme. Një sanksion nuk duhet të jetë më i lartë se domosdoshmëria e zbatimit të drejtësisë dhe nuk mund të jetë jo proporcionale duke pasur parasysh vlerat e mbrojtura sociale. Prandaj, sipas këtij parimi të ndërhyrjes minimale, duhet të supozohet se dënimi më i ulët i parashikuar në ligj do të jetë i mjaftueshëm, i përshtatshëm dhe një pikë referimi për situatat standarde që mund të përfshihen në dispozitën ligjore inkriminuese. Një sanksion penal lidhet me qëllimet e sigurimit të parandalimit individual dhe rehabilitimit, duke siguruar parandalim të përgjithshëm, duke shprehur mosmiratim social të shkeljes së vlerave sociale të mbrojtura dhe forcimin e respektit shoqëror ndaj ligjit.
146. Në pajtim me nenin 73 të KPK-së, gjykata gjatë marrjes së aktgjykimit duhet të marrë parasysh qëllimin e dënimit, të gjitha rrethanat që janë relevante për zbutjen ose

përkeqësimin e dënimit, në veçanti, shkallën e përgjegjësisë penale, motivet për kryerjen e veprës penale, intensitetin e rrezikut për vlerën e mbrojtur, rrethanat në të cilat është kryer vepra, sjelljen e kaluar të kryerësit të veprës, rrethanat personale dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale. Dënimi në fund duhet të jetë në proporcion me rëndësinë e veprës dhe sjelljen dhe rrethanat e kryerësit të veprës.

147. Në përgjithësi, Gjykata e Apelit, në shqyrtimin e dënimeve, kufizohet nga gjendja faktike e vendosur në aktgjykim dhe nga vlerësimi i rregullave ligjore të zbatueshme për caktimin e dënimit nga Gjykata Themelore. Trupi gjykues nuk obligohet nga pesha specifike e dhënë nga Gjykata Themelore në secilën rrethanë rënduese dhe lehtësuese. Fakte të tjera të supozuara në favor ose në dëm të pandehurve, por jo të përcaktuara nga Gjykata Themelore, nuk mund të merren në konsideratë për të përcaktuar dënimin.

148. Trupi gjykues e ka liruar të pandehurin G.K. nga veprat penale të Sulmit, në kundërshtim me nenin 187 (1) të KPK në lidhje me nenin 31 të KPK-së (*Akuza 2*); Sulm, në kundërshtim me nenin 187 (1) të KPK (*Akuza 8*); Sulm, në kundërshtim me nenin 187 (2) të KPK në lidhje me nenin 31 të KPK (*Akuza 3*); Sulm, në kundërshtim me nenin 187 (2) të KPK në lidhje me nenin 31 të KPK (*Akuza 18*) dhe Sulm në kundërshtim me nenin 187 (2) të KPK-së (*Akuza 9*).

149. Duke marrë parasysh se i pandehuri G.K. u lirua nga 5 (pesë) akuza, trupi gjykuesi konsideron se dënimi i shqiptuar duhet të rishqyrtohet. Trupi gjykues merr në konsideratë rrethanat rënduese në vijim: i pandehuri ka kryer veprën penale kundër disa të dëmtuarve, të cilët në atë kohë ishin prangosur, duke përdorur dhunë dhe ka marrë shumë pjesë në veprën penale. Trupi gjykues më tej konsideron rrethanat lehtësuese si në vijim: i pandehuri nuk ka të kaluar penale, kishte karakter të mirë personal dhe sillej me një respekt të madh gjatë gjykimit. Trupi gjykues më tej pajtohet me vlerësimin e Gjykatës Themelore se pozita zyrtare e mbrojtësit gjatë veprës penale nuk duhet të konsiderohet si një rrethanë rënduese sepse ky është një nga elementet e veprës penale të Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike. Megjithatë, trupi gjykues nuk pajtohet me Gjykatën Themelore se vendosja e dënimit plotësues do të ndihmonte në arritjen e qëllimit të sanksionit penal. Prandaj, trupi gjykues heqë dënimin plotësues në lidhje me të pandehurin G.K..

150. Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e sipërpërmendura, i pandehuri G.K. dënohet si më poshtë: për veprën penale të Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198 (1) të KPK-së të kryer kundër të dëmtuarit M.J. (*akuza 1*), në pajtim me nenet 41, 45, 74 dhe 198 (1) të KPK-së, i pandehuri dënohet me burgim prej 8 (tetë) muajsh, ekzekutimi i të cilit pezullohet në bazë të nenit 51 (2) të KPK për periudhën e verifikimit prej 2 (dy) vjetësh nëse i pandehuri nuk kryen një vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit. Për veprën penale të Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198 (1) të KPK-së të kryera kundër palës së dëmtuar I.P. (*Akuza 1*), sipas neneve 41, 45, 74 dhe 198 (1) të KPK, i pandehuri dënohet me burgim prej 8 (tetë) muajsh, ekzekutimi i të cilit pezullohet në bazë të nenit 51 (2) të KPK për periudhën e verifikimit prej 2 (dy) vjetësh nëse i pandehuri nuk kryen një vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit. Për veprën penale të Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198 (1) të KPK-së në lidhje me nenin 31 të KPK-së, të kryer në vazhdimësi ndaj palës së dëmtuar B.M. (*akuzat 5 dhe 13*), sipas neni 41, 45, 74 dhe 198 (1) të KPK-së, i pandehuri dënohet me burgim prej 8 (tetë) muajsh, ekzekutimi i të cilit pezullohet në bazë të nenit 51 (2) të KPK për periudhën e verifikimit prej 2 (dy) vjetësh nëse i pandehuri nuk kryen një vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit. Për veprën penale të keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198 (1) të KPK në lidhje me nenin 31 të KPK-së të kryera kundër palës së dëmtuar D.V. (*akuza 17*), në pajtim me nenet 41, 45, 74 dhe 198 (1) të KPK-së, i pandehuri dënohet me burgim prej 8 (tetë) muajsh, ekzekutimi i të cilit pezullohet në bazë të nenit 51 (2) të KPK për periudhën e verifikimit prej 2 (dy) vjetësh nëse i pandehuri nuk kryen një vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit. Për veprën penale të Kanosjes, në kundërshtim me nenin 185 (4), në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së, dhe në lidhje me nenin 31 të KPK-së të kryera kundër të dëmtuarit B.M. (*akuza 7*), në pajtim me Nenet 41, 45, 74 dhe 185 (4) të KPK-së, i pandehuri dënohet me burgim prej një (një) viti, ekzekutimi i të cilit pezullohet në bazë të nenit 51 (2) të KPK për periudhën e verifikimit prej 2 (dy) vjetësh nëse i pandehuri nuk kryen një vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit. Në bazë të nenit 80 të KPK-së, Gjykata e Apelit shqipton dënimin të përgjithshëm prej 1 (një) viti dhe 6 (gjashtë) muajsh burgim, ekzekutimi

i të cilit pezullohet në bazë të nenit 51 (2) të KPK për periudhën e verifikimit prej 3 (tri) vjetësh nëse i pandehuri nuk kryen një vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit.

151. Trupi Gjykses e shfajësoi të pandehurin S.S. për veprat penale të Sulmit, në kundërshtim me nenin 187 (1) të KPK-së (*Akuza 2*) dhe veprat penale të Sulmit, në kundërshtim me nenin 187 (2) të KPK-së (*akuza 3*).

152. Duke marrë parasysh se i pandehuri S.S. u shfajësua nga 2 (dy) akuza, trupi gjykses konsideron se dënimi i shqiptuar duhet të rishqyrtohet. Trupi gjykses merr në konsideratë rrethanat rënduese në vijim: i pandehuri ishte një udhëheqës i ekipit dhe kishte përgjegjësi ekskluzive për të mbikëqyrur të pandehurit e tjerë, kreu veprën penale kundër disa palëve të dëmtuara, të cilët në atë kohë ishin prangosur, ka përdorur dhunë dhe ka marrë shumë pjesë në veprën penale. Trupi gjykses më tej konsideron rrethanat lehtësuese si në vijim: i pandehuri nuk ka të kaluar penale, kishte karakter të mirë personal dhe sillej me një respekt të madh gjatë gjykimit. Trupi gjykses më tej pajtohet me vlerësimin e Gjykatës Themelore se pozita zyrtare e të pandehurit gjatë veprës penale nuk duhet të konsiderohet si një rrethanë rënduese sepse ky është një nga elementet e veprës penale të keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimit publik. Megjithatë, trupi gjykses nuk pajtohet me Gjykatën Themelore se vendosja e dënimit plotësues do të ndihmonte në arritjen e qëllimit të sanksionit penal. Prandaj, trupi gjykses heq dënimin plotësues në lidhje me të pandehurin S.S..

153. Pas shqyrtimit të të gjitha rrethanave të lartpërmendura, i pandehuri S.S. dënohet si më poshtë: Për veprën penale të Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198 (1) të KPK-së, të kryer në vazhdimësi ndaj palës së dëmtuar B.M.1 (Akuzat 1 dhe 15), në pajtim me nenet 41, 45, 74 dhe 198 (1) të KPK-së, i pandehuri dënohet me burgim prej një (një) viti, ekzekutimi i të cilit pezullohet në bazë të nenit 51 (2) të KPK për periudhën e verifikimit prej 2 (dy) vjetësh nëse i pandehuri nuk kryen një vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit; Për veprën penale të Keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198 (1) të KPK-së të kryera kundër palës së dëmtuar I.P. (Akuzat 1), në pajtim me nenet 41, 45, 74

dhe 198 (1) I KPP-së, i pandehuri dënohet me burgim prej një (një) viti, ekzekutimi i të cilit pezullohet në bazë të nenit 51 (2) të KPK për periudhën e verifikimit prej 2 (dy) vjetësh nëse i pandehuri nuk kryen një vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit. Në bazë të nenit 80 të KPK-së, Gjykata e Apelit shqipton dënimin total prej 1 (një) vit dhe 6 (gjashtë) muaj, burgim ekzekutimi i të cilit pezullohet në bazë të nenit 51 (2) të KPK për periudhën e verifikimit prej 3 (tri) vjetësh nëse i pandehuri nuk kryen një vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit.

154. Gjykata Themelore gjeti se S.A. u shpall fajtor për veprat penale në vijim: Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198 (1) të KPK-së në lidhje me nenin 31 të KPK-së dhe u dënua me burgim prej një (1) viti, ekzekutimi i të cilit pezullohet në bazë të nenit 51 (2) të KPK për periudhën e verifikimit prej 2 (dy) vjetësh nëse i pandehuri nuk kryen një vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit dhe me ndalim të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik për 2 (dy) vjet; dhe Kanosje, në kundërshtim me nenin 185 (4) të KPK-së, të kryer në bashkëkryerje në pajtim me nenin 31 të KPK-së dhe u dënua me burgim prej një (një) viti, ekzekutimi i të cilit pezullohet në bazë të nenit 51 (2) të KPK për periudhën e verifikimit prej 2 (dy) vjetësh nëse i pandehuri nuk kryen një vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit dhe urdhëroi të që mos mbante asnjë lloj arme gjatë kohës së verifikimit. Ai u dënua me dënim të përgjithshëm prej 1 (një) viti dhe 6 (gjashtë) muaj burgim, ekzekutimi i të cilit pezullohet në bazë të nenit 51 (2) të KPK për periudhën e verifikimit prej 2 (dy) vjetësh nëse i pandehuri nuk kryen një vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit dhe urdhëroi që të mos mbante asnjë lloj arme gjatë kohës së verifikimit. Të pandehuri më tej i është caktuar dënimi për ndalimin e ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose shërbimin publik për 2 (dy) vjet.

155. Trupi gjykues konsideron se Gjykata Themelore zbatoi në mënyrë korrekte rrethanat lehtësuese dhe rënduese në lidhje me të pandehurin S.A.; megjithatë, trupi gjykues nuk është dakord se përcaktimi i detyrimeve shtesë gjatë dënimit me kusht ose caktimi i dënimit plotësues do të ndihmonte në arritjen e qëllimit të sanksionit penal. Prandaj, dënimi plotësues

dhe obligimet plotësuese të përcaktuara në bazë të neneve 58 (2) dhe 59 (1) (1.11) të KPP-së janë hequr në lidhje me S.A..

156. Trupi gjykues e shfajësoi të pandehurin N.D. nga veprat penale të Sulmit, në kundërshtim me nenin 187 (1) të KPK-së dhe veprat penale të Sulmit, në kundërshtim me nenin 187 (2) të KPK në lidhje me nenin 31 të KPK-së (*akuza 18*).

157. Duke marrë parasysh se i pandehuri N.D. u shfajësua nga 2 (dy) akuza, Trupi Gjykues konsideron se dënimi i shqiptuar duhet të rishqyrtohet. Trupi gjykues i merr parasysh rrethanat e mëposhtme rënduese: i pandehuri e ka kryer veprën penale kundër D.V. në mënyrë shumë të dhunshme dhe e ka rrahur dikë që ishte rrahur tashmë. Trupi gjykues më tej i merr parasysh rrethanat lehtësuese si në vijim: i pandehuri nuk ka të kaluar penale, kishte karakter të mirë personal dhe sillej me një respekt të madh gjatë gjykimit. Trupi gjykues më tej pajtohet me vlerësimin e Gjykatës Themelore se pozita zyrtare e të pandehurit gjatë veprës penale nuk duhet të konsiderohet si një rrethanë rënduese sepse ky është një nga elementet e veprës penale të keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike. Megjithatë, trupi gjykues nuk pajtohet me Gjykatën Themelore se caktimi i dënimit plotësues do të ndihmonte në arritjen e qëllimit të sanksionit penal. Prandaj, trupi gjykues e heqë dënimin plotësues në lidhje me të pandehurin N.D..

158. Pas shqyrtimit të të gjitha rrethanave të lartpërmendura, i pandehuri N.D. dënohet si më poshtë: për veprën penale të keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198 (1) të KPK në lidhje me nenin 31 të KPK kundër palës së dëmtuar B.M. (*akuza 5*), në pajtim me nenet 41, 45, 74 dhe 198 (1) të KPK-së, i pandehuri dënohet me burgim prej një (1) viti, ekzekutimi i të cilit pezullohet në bazë të nenit 51 (2) të KPK për periudhën e verifikimit prej 2 (dy) vjetësh nëse i pandehuri nuk kryen një veprë tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit; dhe për veprën penale të keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198 (1) të KPK në lidhje me nenin 31 të KPK kundër palës së dëmtuar D.V. (*akuza 17*), në pajtim me

nenet 41, 45 , 74 dhe 198 (1) të KPK-së, i pandehuri dënohet me burgim prej një (një) viti, ekzekutimi i të cilit pezullohet në bazë të nenit 51 (2) të KPK për periudhën e verifikimit prej 2 (dy) vjetësh nëse i pandehuri nuk kryen një vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit. Në bazë të nenit 80 të KPK-së, Gjykata e Apelit shqipton dënimin e përgjithshëm prej 1 (një) viti dhe 6 (gjashtë) muaj burgim, ekzekutimi i të cilit pezullohet në bazë të nenit 51 (2) të KPK për periudhën e verifikimit prej 2 (dy) vjetësh nëse i pandehuri nuk kryen një vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit.

159. Trupi gjykues e shfajësoi N.Z. për veprën penale të Sulmit, në kundërshtim me nenin 187 (1) të KPK-së (*Akuza 2*).

160. Duke marrë parasysh se i pandehuri N.Z. u shfajësua nga 1 (një) akuzë, trupi gjykues konsideron se dënimi i shqiptuar duhet të rishqyrtohet. Trupi gjykuesi merr në konsideratë dënimin e caktuar nga Gjykata Themelore në të vetmen akuzë të mbetur dhe konsideron se Gjykata Themelore ka vlerësuar si duhet rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Megjithatë, trupi gjykues nuk pajtohet me Gjykatën Themelore se caktimi i dënimit plotësues do të ndihmonte në arritjen e qëllimit të sanksionit penal. Prandaj, trupi gjykues heq dënimin plotësues në lidhje me të pandehurin N.Z..

161. Pas shqyrtimit të të gjitha rrethanave të lartpërmendura, i pandehuri N.Z. dënohet si më poshtë: për veprën penale të keqtrajtimit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, në kundërshtim me nenin 198 (1) të KPK-së të kryer në vazhdimësi ndaj palës së dëmtuar I.P. (Pikat 1 dhe 11), në pajtim me nenet 41, 45, 74 dhe 198 (1) të KPK-së, i pandehuri dënohet me 6 (gjashtë) muaj burgim me ekzekutimin e pezulluar sipas nenit 51 (2) të KPK për periudhën e verifikimit prej 2 (dy) viteve nëse i pandehuri nuk kryen një vepër penale tjetër gjatë periudhës së verifikimit.

162. Trupi gjykues e shfajësoi të pandehurin I.R. për veprën penale të Sulmit, në kundërshtim me nenin 187 (1) të KPK-së (*Akuza 2*).

163. Duke marrë parasysh se i pandehuri I.R. u shfajësua nga 1 (një) akuzë, trupi gjykues konsideron se dënimi i shqiptuar duhet të rishqyrtohet. Trupi gjykues merr në konsideratë dënimin e caktuar nga Gjykata Themelore në të vetmen akuzë të mbetur dhe konstaton se Gjykata Themelore ka vlerësuar si duhet rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Megjithatë, trupi gjykues nuk pajtohet me Gjykatën Themelore se caktimi i dënimit plotësues do të ndihmonte në arritjen e qëllimit të sanksionit penal. Prandaj, trupi gjykues heqë dënimin plotësues në lidhje me të pandehurin I.R..

164. Gjykata e Apelit - për arsyet e sqaruara më lart –pjesërisht e aprovon ankesën e mbrojtjes dhe shqipton dënime më të lehta.

Është vendosur si në dispozitiv lidhur me atë si u tha më sipër.

Aktgjykimi me shkrim i arsyetuar përfundoi më 10 korrik 2017.

Kryetari i trupit gjykues

Vahid Halili

Gjyqtar i Gjykatës së Apelit

Procesmbajtësi

Sandra Gudaityte

Zyrtare ligjore e EULEX-it

Anëtarët e trupit gjykues

Radostin Petrov

Gjyqtar i EULEX-it

Fillim Skoro

Gjyqtar i Gjykatës së Apelit

